

---

# Menaxhimi i Mbeturinave në Kosovë: Identifikimi i sfidave të sektorit

---

HULUMTIM

---

05/2018



---

# Menaxhimi i Mbeturinave në Kosovë: Identifikimi i sfidave të sektorit

---

Autore:	<b>Dora Musa</b>
Kontribues:	<b>Burim Ejupi</b>
Programi:	<b>Zhvillimi i Qëndrueshëm</b>
Data e publikimit:	<b>Maj 2018</b>
Foto e kopertinës:	<b>Visual Hunt</b>



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**Rockefeller  
Brothers  
Fund**

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

## Përmbajtja

Hyrje.....	5
Metodologjia.....	7
Efektet në Mjedis dhe Shëndet.....	8
Korniza Ligjore.....	9
Korniza Institucionale e Menaxhimit të Mbeturinave .....	16
Burimet Financiare të Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave .....	19
Vështrim i Praktikave Aktuale të Menaxhimit të Mbeturinave në Kosovë .....	20
Sfidat dhe Pengesat e Menaxhimit të Mbeturinave në Kosovë .....	25
Analiza krahasuese.....	29
Përfundimet .....	31
Rekomandimet.....	33
Appendix .....	35
Korniza Ligjore dhe Strategjike e Menaxhimit të Mbeturinave .....	35

## Akronimet

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

AMMK – Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

BAT – Teknologjia më e mirë e mundshme

BE – Bashkimi Evropian

GIZ – Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

GHGs – Gazërat serrë

JICA – Japan International Cooperation Agency

KMDK – Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovës

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MBT – Trajtim biologjik mekanik

MEZH – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MF – Ministria e Financave

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MSH – Ministria e Shëndetësisë

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

NjPMNP – Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike

PAMKos – Shoqata për Pastërti dhe Ambient të Kosovës

RAE – Roma, Ashkali, dhe Egjiptian

TC – Termocentral

U.A – Udhëzime Administrative

USAID – United States Agency for International Development

ZRRUM – Zyra e Rregullator të Ujit dhe Mbeturinave

## Hyrje

Në mbarë botën, aktivitetet ekonomike kanë degraduar mjedisin çdo vit më shumë e më shumë. Por, këto degradime të mjedisit janë më së shumti prezente në vendet në zhvillim, të cilat në të njëjtën kohë janë të shoqëruara edhe me shumë problem të natyrave të ndryshme. Siç janë problemet me varfëri, pabarazi gjinore dhe sociale, korrupsion dhe nepotizëm, paqëndrueshmëri politike, pasiguri të financiare, etj. Si shtet në zhvillim e sipër, edhe Kosova aktualisht po iu ekspozohet këtyre problemeve. Sidoqoftë, viteve të fundit problemet që kërkojnë më së shumti vëmendje janë ato që rrezikojnë qëndrueshmërinë e mjedisit, e të cilat fuqishëm kërcënojnë shëndetin e kosovarëve dhe ambientit në të cilin ata jetojnë. Duke konsideruar sfidat nëpër të cilat po kalon mjedisi, një problem i përrjetshëm dhe shqetësues mbetet ai i menaxhimit të mbeturinave, që vije si rezultat i shumë faktorëve të kombinuar.

Me rritjen konstante të popullsisë së botës dhe industrializimit të shpejtë, çështja e gjenerimit të mbeturinave filloj të merr shumë vëmendje nga organizatat dhe komunitetet ndërkombëtare, për shkak të pasojave të vëzhguara në mjedis, shëndetin publik, dhe ekonominë; e posaçërisht kur flitet për mbeturinat e ngurta komunale. Konsumimi i madh i produkteve të ambalazuara dhe ndryshimi i mënyrës së jetesës të njerëzve nëpër botë kanë kontribuar në ekstraktim të paqëndrueshëm të burimeve dhe shkallë të lartë të gjenerimit të mbeturinave. Numri i vlerësuar i popullsisë globale që do të jetojë në zonat urbane në vitin 2025 është 4.3 miliardë me shkallë të gjenerimit të mbeturinave prej 1.42 kg/banor/ditë<sup>1</sup>, përderisa shkalla tanishme është rreth 1.3 kg/banor/ditë<sup>2</sup>. Për shkak të migrimit të brendshëm në drejtim të zonave urbane, me ç'rast rritet shkalla e gjenerimit të mbeturinave, këto vendbanime prodhojnë më shumë mbeturina se zonat rurale. Kjo vjen edhe si rezultat i raportit të drejtpërdrejtë midis shkallës së gjenerimit të mbeturinave dhe të ardhurave të disponueshme. Si pasojë, zonat rurale priren të konsumojnë më pak të mira për shkak të ardhurave të ulëta. Prandaj, mund të thuhet se gjenerimi i mbeturinave është i lidhur pozitivisht me urbanizimin dhe rritjen ekonomike. Krahas modelit të konsumit të të mirave që luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e çështjes së menaxhimit të mbeturinave, industrializimi gjithashtu ka qenë kontribues i dukshëm në rritjen e shkallës së gjenerimit të mbeturinave. është e vërtetuar se shtetet me praktika të industrializimit të lartë gjenerojnë më shumë mbeturina, për shembull, Shtetet e Bashkuara, Brazili, Kina, Japonia, dhe Gjermania, të cilat konsiderohen si gjeneratorët kryesor të mbeturinave<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Hoornweg, D., dhe Bhada-Tata, P. (2012). "What a Waste: A Global Review of Solid Waste Management". Fq. 8. *World Bank*. [https://siteresources.worldbank.org/INTURBANDEVELOPMENT/Resources/336387-1334852610766/What\\_a\\_Waste2012\\_Final.pdf](https://siteresources.worldbank.org/INTURBANDEVELOPMENT/Resources/336387-1334852610766/What_a_Waste2012_Final.pdf)

<sup>2</sup> United Nations Environment Programme. (2015). "Global Waste Management Outlook". Fig. 3.8., Fq. 61. <http://www.unep.org/ourplanet/september-2015/unep-publications/global-waste-management-outlook>

<sup>3</sup> Simmons, A.M. (2016). "The world's trash crisis, and why many Americans are oblivious". *LA Times*. <http://www.latimes.com/world/global-development/la-fg-global-trash-20160422-20160421-snap-htmlstory.html>

Meqenëse kërkesa dhe furnizimi i të mirave mbeten në majat e tyre, përfundimisht cikli jetësor i produkteve do të përfundojë duke u hedhur në natyrë në formën e mbeturinave, të cilat nëse nuk trajtohen dhe asgjësohen siç duhet imponojnë eksternalitete serioze në ekosisteme dhe shkaktojnë kosto të rënda shëndetësore në shoqëri. Për këtë arsye, në shumicën e shteteve evropiane përgjegjësitë e menaxhimit të mbeturinave bien nën kompetencat e komunave. Prandaj, nëse nuk merren masa konkrete mbeturinat do të zvogëlojnë vlerën dhe përfitimet e mjedisit, rrisë nivelin e emisioneve të gazrave serrë në atmosferë dhe ndotësit në sipërfaqet ujore, dhe numrin e sëmundjeve infektive etj. Për këtë, në një skenar ideal ku sektori i menaxhimit të mbeturinave funksionon në mënyrë të përkryer, përfitimet gjithmonë tejkalojnë kostot.

Faktorët që kontribuojnë në keq menaxhimin e mbeturinave në Kosovë janë të ngjashme me problemet e hasura në këtë fushë në nivel global. Së pari, një dekadë pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë pati një rritje të shpejtë të popullsisë dhe migrimit t] brendshëm, të cilat kanë rritur shkallën e gjenerimit të mbeturinave dhe hudhjen e tyre në qytetet kryesore, për shkak të konsumimit të madh të të mirave. Së dyti, institucionet relevante kanë hartuar legjislacionin në përputhje me direktivat e BE-së (të cilat standarde dhe synime janë vështirë të arritshme duke konsideruar në fazën në të cilën gjendet për momentin kapacitetet e Kosovës, le të jenë ato burime financiare apo njerëzore) dhe implementimi i të cilit duket se nuk ndodhë siç duhet, andaj nuk tregon ndonjë rezultat pozitiv në përmirësimin e pasojave. Së treti, autoritetet lokale janë të mbingarkuara me përgjegjësi të cilat nuk janë mirë të definuara ndërmjet institucioneve kompetente të këtij sektori, duke i bërë kështu që ato të mos ofrojnë efikasitet në shërbimet bazike në baza ditore. Së katërti, industrializimi i shpejtë dhe industrinë e forta që prodhojnë të mira dhe lirojnë materie të rrezikshme nuk kanë mënyra të veçantë dhe vend të dedikuar për hudhjen e mbetjeve të prodhimit. Krahas kësaj, dekomisionimi i Termocentralit (TC) Kosova A mbetet ende një problem serioz që përfshin mjedisin, pasiçë në momentin kur të jetë jashtë funksionit, do të gjenerojë një sasi të konsiderueshme të mbeturinave. Kjo çështje kërkon një trajtim të veçantë nga politik bërësit dhe autoritetet kompetente. Së pesti, metodat e avancuara teknologjike nuk janë të disponueshme në Kosovë për shkak të mungesës së investimeve apo financimit dhe kostove të larta që lidhen me këto metoda. Së fundmi, zakonet e papërshtatshme të qytetarëve dhe mungesa e vetëdijesimit efektiv janë elemente vendimtare në menaxhimin e problemit të mbeturinave.

Zanafilla e problemit në rastin e Kosovës qëndron në sasinë e madhe të mbeturinave të gjeneruara dhe mungesa e metodave joadekuate për trajtimin dhe hudhjen e tyre. Duke u bazuar në legjislacionin e Kosovës, mbeturina është çdo substancë apo material që hidhet nga prodhuesi i mbeturinës<sup>4</sup>, dhe

---

<sup>4</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2012). "Ligji Nr. 04/L-060 Për Mbeturina". Fq. 2. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2829>

përderisa përbërja e mbeturinës ndryshon midis produkteve, ato kategorizohen në bazë të ekspozimit ndaj rrezikut, konkretisht ato ndahen në të rrezikshme, parrezikshme, dhe inerte<sup>5</sup>. Për më tepër, ato mund të klasifikohen në bazë të burimit të gjenerimit të mbeturinave, siç mund të jenë ato komunale, komerciale, industriale, dhe medicinale. Menaxhimi i mbeturinave përfshin të gjitha aktivitetet, që do të thotë mbledhjen, trajtimin, ripërdorimin, procesimin, riciklimin, dhe hudhjen, të cilat aktivitete synojnë të reduktojnë nivelin e gjenerimit të mbeturinave në mënyrë që të parandalohen efektet potenciale negative të imponuara në mjedis dhe shëndetin publik. Kudo që ndodh menaxhimi i papërshtatshëm i mbeturinave atëherë këto dy efekte negative intensifikohen edhe më tepër.

Për shkak të efekteve negative, më specifiku ato të mjedisore, shëndetësore, dhe ekonomike, që menaxhimi joadekuat dhe jo i rregullt i mbeturinave imponon në komunitet, thërret për veprim të menjëhershëm prej institucioneve qendrore dhe lokale në Kosovë në mënyrë që pasojat të lehtësohen për gjenerata e tanishme dhe atyre që do të vijnë në të ardhmen. Për këtë arsye, ky punim do të fokusohet specifiku në sektorin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, hisedarët kryesor dhe sfidat e tyre kundrejt ofrimit të përshtatshëm dhe efektiv të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave tek komuniteti. Menaxhimi i mirëfilltë i këtyre detyrave do të ndihmojë në formimin e një sektori stabil prej të cilit qytetarët e Kosovës do të përfitojnë drejtpërsëdrejti në termat e një ekonomie të dobishme, mjedis të pastër dhe jetë të shëndetshme. Qëllimi i këtij punimi është që të servojë rekomandime dhe përfundime që do të mund të promovonin zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet përvetësimit të praktikave funksionale të menaxhimit të mbeturinave të cilat do të rezultojnë në një mjedis më të pastër për komunitetet brenda Kosovës.

## Metodologjia

Sektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është përballur me plotë sfida për një kohë të gjatë tani. Ndërsa ende përpiqet të krijojë një sektor stabil me impakte negative të imponuara në mjedis dhe shëndet publik, organizatat ndërkombëtare janë duke i dhënë rëndësi të madhe çështjes së mbeturinave, dhe duke e bërë këtë që të ndihmojë Kosovën të arrij një zhvillim mjedisor të qëndrueshëm.

Në mënyrë që të marrim një kuptim të plotë sa i përket problemeve të këtij sektori, metodat e hulumtimit kualitativ, si hulumtim sekondar dhe intervista, janë kryer. Duke filluar nga metoda e parë, hulumtimi sekondar dha një pasqyrë të situatës aktuale të sektorit të mbeturinave në të gjithë botën, e veçanërisht të Kosovës në vitet e fundit. Për më tepër, ndihmojë në definimin e kornizës institucionale dhe ligjore të sektorit të mbeturinave në Kosovë. Ky rishikim i literaturës ofroj raste për analiza krahasimore të cilat ndihmuan në përpilimin e rekomandimeve të cilat janë bazuar në praktikat

---

<sup>5</sup> Fq. 10.

dhe rezultatet e tyre nëpër botë, posaçërisht në BE. Prandaj, pjesa e parë e këtij punimi përfshin gjendjen aktuale dhe impaktet e vëzhguara në botë të mbeturinave, dhe vetëm pastaj fokusi kalon te Kosova.

Krahas metodës të lartpërmendur, intervistat janë mbajtur si pjesë përmbajtësore e qasjes më të saktë në problemet e sektorit dhe pikëpamjet e hisedarëve sa i përket kësaj çështje mjedisore të cilat informacione ndihmuan në dizajnimin e rekomandimeve. Intervistat e pastrukturuara janë mbajtur me hisedarët kryesor të sektorit, specifikisht MMPH, KMDK, NjPMNP, dhe komunën e Obiliqit. Shënime dhe regjistrime (me aprovimin e të intervistuarëve) janë mbledhur gjatë takimeve me hapësirë kohore prej 30 minuta deri në një orë e që ndihmuan në analizimin e detajeve pas përfundimit të takimeve.

Sa i përket kufizimeve, janë hasur disa gjatë procesit të hulumtimit. Pikë së pari, ka mungesë të të dhënave për menaxhimin e mbeturinave; informacion që duhet publikuar nga autoritetet lokale. Këto të dhëna janë të limituara në numër pasiçë raportimi nuk bëhet në mënyrë periodike, për këtë arsye duhet vlerësuar të dhënat që mungojnë në bazë të atyre që janë të disponueshme për publikun. Kjo shpjen drejt supozimit të të dhënave aktuale dhe variablat e tjera të lidhura me këtë sektor. Edhe gjatë intervistave me palët e përfshira, hisedarët kishin mungesë informacioni dhe statistikave rreth situatës aktuale në terren sa i përket sektorit të menaxhimit të mbeturinave. Për më tepër, shumica e të intervistuarve potencial që janë identifikuar në fazat fillestare të hulumtimit e që ishin pjesë e institucioneve në nivel qendror por edhe atë lokal, nuk ishin të gatshëm të kontribuonin me informacionet e tyre, për këtë shkak në mënyrë që punimi të ofrojë një pasqyrim sa më realist, u kombinuan të dhëna të disponueshme nga hulumtimi primar dhe ai sekondar.

## Efektet në Mjedis dhe Shëndet

Sa i përket degradimit të mjedisit, shkatërrimi i të mirave që ofron ambienti, prezenca e aromave të pakëndshme, kontaminimi potencial i burimeve të jetës si uji, ajri dhe toka pjellore janë vetëm disa prej rezultateve negative që menaxhimi i mbeturinave shoqërohet. Një prej metodave për trajtimin e mbeturinave me kosto më të ulët e që është mjaft e zakonshme në gjithë botën është ajo e hedhjes në deponi; teknikë kjo që shoqërohet me pasoja të rënda në ekosistem dhe shëndetin e njerëzve. Në Kosovë deponitë jo sanitare dhe djegia e mbeturinave mbeten disa prej sfidave mjedisore më të rënda që shkatërrojnë natyrën. Hudhja e mbeturinave në deponi dihet se liron gazra dhe kullim të cilat ndodhin si rezultat i dekompozimit të mikroorganizmave. Kjo ndikon në krijimin e sëmundjeve, kontaminimin e ajrit, ujit dhe tokës, dhe humbjes së biodiversitetit. Për më tepër, për shkak të përzierjes të përbërjes të mbeturinave, ato mund të kenë efekte vdekjeprurëse në mjedis dhe njerëz, si p.sh. mund të iniciojnë zjarre, dëmtime të pronave private dhe publike, kontaminim të ujërave



nëntokësore, dhe gjithashtu të kontribuojnë në nxehjen globale pasi lirojnë gazra siç mund të jetë dioksidi i karbonit<sup>6</sup>.

Pasi të ndodhë degradimi i mjedisit, duket se shfaqen probleme të tjera sa i përket shëndetit publik, siç është përhapja e viruseve dhe sëmundjeve vdekjeprurëse. Ndërsa burimet e jetës ndoten nga praktikat joefikase të menaxhimit të mbeturinave, shqetësimi fillon të rritet në lidhje me sëmundjet e veshkave, zemrës, sistemit nervor, lëkurës, mushkërive dhe problemet e frymëmarrjes, etj.<sup>7</sup>

Nëse nuk ndërmerren masa ndaj situatës aktuale jo të mirë të menaxhimit të mbeturinave, do të thoshte se po i adaptohem shkatërrimit të ambientit dhe imponimit të rreziqeve që vihen kundrejt komunitetit, dhe kostot nuk do të barteshin vetëm tek gjeneratat e tanishme por edhe të atyre që do të vijnë në të ardhmen. Por edhe nëse merren masa të menjëhershme, një kohë e gjatë do të duhej të kaloj derisa përfitimet e praktikave të mira të menaxhimit të mbeturinave t'i tejkalojnë kostot dhe situata mjedisore të stabilizohet. Prandaj, nevoja e intervenimit për zbutjen e problemit të menaxhimit të mbeturinave do të zvogëlohet gradualisht për gjeneratat e ardhshme.

Me fjalë të tjera, praktikat joadekuate të menaxhimit të mbeturinave në përgjithësi cenojnë zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit. Ekziston nevoja për të adaptuar metoda eco-friendly (të përshtatshme për ambientin) dhe teknika efikase për hudhjen e mbeturinave, dhe monitorimin e trajtimit të tyre në mënyrë që të mos dëmtojnë ambientin dhe mirëqenien e njerëzve.

## Korniza Ligjore

Bazuar në kornizën kushtetuese në të cilën principe autoritetet kosovare qeverisin, duhet garantuar mbrojtja e mjedisit për qytetarët. Sipas nenit 7,

*“Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.”<sup>8</sup>.*

Në parim, vlerat e lartpërmendura janë fundamentale për qeverisjen demokratike të Kosovës. Neni 52 shkon edhe më tej në përcaktimin e përgjegjësive në lidhje me ambientin, i cili cek se përgjegjësitë kryesore të anëtarëve të komunitetit janë të mbrojnë natyrën, biodiversitetit, dhe trashëgiminë

---

<sup>6</sup> N. Ejaz, N. Akhtar, H. Nisar & U. Ali Naeem. (2010). ‘Environmental impacts of improper solid waste management in developing countries: a case study of Rawalpindi City’. *The Sustainable World*. WIT Transactions on Ecology and the Environment, Pakistan. Fq. 385-386.

<https://www.witpress.com/Secure/elibrary/papers/SW10/SW10035FU1.pdf>

<sup>7</sup> Rushton, L. (2003). ‘Health hazards and waste management’. Fq. 187. *British Medical Bulletin*. The British Council. Leicester, United Kingdom.

[https://pdfs.semanticscholar.org/d3df/cf0933b001fa7ef01ce057df038f1d577ba5.pdf?\\_ga=2.76343260.856575842.1509357761-933535303.1509357761](https://pdfs.semanticscholar.org/d3df/cf0933b001fa7ef01ce057df038f1d577ba5.pdf?_ga=2.76343260.856575842.1509357761-933535303.1509357761)

<sup>8</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës. “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”. Fq. 2. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

kombëtare<sup>9</sup>. Për më tepër, çdo anëtar ka të drejtë të shprehë mendimin dhe shqetësimin e tij lidhur me çështje të ndryshme që ndikojnë në mjedisin e tyre në të cilin jetojnë, gjë që mund të ndikojë në marrjen e vendimeve nga institucionet publike.

Megjithatë, për të identifikuar mangësitë konkrete që ekzistojnë në lidhje me legjislacionin aktual, na duhet të shqyrtojmë në hollësi Ligjin mbi Mbeturinat, në mënyrë që të jemi në gjendje të listojmë pengesat dhe arsyet prapa dizajnit dhe zbatimit joefikas. Në vitin 2012, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin e shfuqizuar për mbeturina, i cili i ndryshoi motivet e mëparshme të këtij ligji. Qëllimi kryesor i ligjit mbi mbeturina mbetet akoma i njëjti e që është të ofrojë një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm për kosovarët. Nëse legjislacioni i mëparshëm nuk i kushtoi shumë vëmendje nevojës për riciklimin, ai i fundit thekson fuqishëm ekonominë qarkulluese, të cilat aktivitetet janë promovuar shumë edhe nga Komisioni Evropian. Përveç riciklimit, ligji i ri barti kompetencat mbi menaxhimin e mbeturinave nga ZRRUM në MMPH dhe në komuna. Pasi u hoqën kompetencat e ZRRUM në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, barra e hartimit të legjislacionit dhe politikave strategjike u hodh në MMPH, por në të njëjtën kohë komunat u lanë me kapacitete të ulëta dhe tejet të kufizuara. Ndërkohë që të dhënat për menaxhimin e mbeturinave në nivel kombëtar kanë stagnuar vetëm me raportim sporadik të AKMM-së.

Sidoqoftë, implementimi i kornizës ligjore të Kosovës, e cila duhet të përafrohet me standardet e vendosura nga BE në Direktivën mbi Mbeturina, mezi është në përputhje me objektivat e përcaktuara prej tyre. Më poshtë janë listuar ligjet specifike mbi mbeturina dhe përafrimin e tyre me Direktivat e BE-së (të paraqitura në përqindje)<sup>10</sup>:

<b>Korniza Ligjore e Menaxhimit të Mbeturinave</b>	<b>%</b>
Ligji mbi Mbeturina Nr.04/L-060	<b>80%</b>
U.A. Nr. 29/2014 mbi Menaxhimin e Llumrave nga Trajtimi	<b>100%</b>
U.A. Nr. 26/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët	<b>75%</b>
U.A. Nr. 27/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Paketimi dhe Mbështjellësit	<b>95%</b>
U.A. Nr. 05/2015 për Menaxhimin e Bifenileve dhe Trifenil Poliklorinuara dhe Mbeturinave me PCB dhe PCT	<b>93%</b>
U.A. Nr. 19/2012 për Menaxhimin e Automjeteve të Vjetëra dhe Komponentet e tyre	<b>100%</b>

<sup>9</sup> Fq. 14.

<sup>10</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës. (2016). 'First Input of Institutions of the Republic of Kosovo to the European Commission 2016 Kosovo Report'. Pg. 182-183. [http://mei-ks.net/repository/docs/inputi\\_i\\_2016\\_-\\_ang.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/inputi_i_2016_-_ang.pdf)

U.A. Nr. 15/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave të tubave fluoreshent që përmbajnë merkur	<b>97%</b>
U.A. Nr. 25/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave të Pajisjeve Elektrike dhe Elektronike dhe Kufizimet në Përdorimin e Substancave të Rrezikshme në Pajisjet Elektrike dhe Elektronike	<b>86%</b>
U.A. Nr. 15/2012 për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave	<b>100%</b>
U.A. Nr. 06/2016 mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit të Ndërtimit të Deponisë së Mbeturinave	<b>100%</b>
U.A. Nr. 21/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Industria Nxjerrëse dhe Minierave	<b>100%</b>

Tab.1. Përafrimi i Kornizës Ligjore të Kosovës me Direktivat e BE-së

Megjithëse Kosova përpiqet të mbështesë riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave, problemi qëndron brenda shtresës së parë të hierarkisë së mbeturinave atë të sasisë të madhe të gjenerimit të mbeturinave. Prandaj, problemi duhet të trajtohet duke filluar nga hapat fillestarë të parandalimit të sasisë të madhe të gjenerimit të mbeturinave e deri te inkurajimi i ripërdorimit të mbeturinave, riciklimit, trajtimit dhe asgjësimit adekuat e përfundimtar të mbeturinave. Për më tepër, tregu jo tërheqës për investitorët mbetet ende një sfidë e madhe, sidomos kur bëhet fjalë për sektorin e riciklimit.

Për të zbutur ndikimet negative të praktikave të menaxhimit të mbeturinave në shëndetin publik dhe mjedisin, ligji propozon një përkufizim adekuat të ciklit të mbeturinave prej gjenerimit e deri tek asgjësimi përfundimtar. Përveç ciklit të mbeturinave, ky ligj merr në konsideratë edhe lëvizjen ndërkufitare të saj, siç është eksporti i mbeturinave të riciklueshme që grumbullohen kryesisht nga sektori joformal dhe kompanitë private. Në vitin 2013, në Kosovë numri i këtyre kompanive që eksportonin mbeturina ishte 36<sup>11</sup>. Megjithatë, këto aktivitete eksportuese lejohen vetëm nëse ato sigurojnë përfitime ekonomike dhe mjedisore.

Përveç eksporteve, importet përfshihen gjithashtu në ligj, kryesisht duke elaboruar kushtet e licencimit dhe kufizimet e tjera. Megjithatë, ligji i mbeturinave përjashton gazrat, mbeturinat dhe toka gjatë aktiviteteve ndërtimore, materialet radioaktive dhe shpërthyes, ndotjen e sipërfaqeve të ujit dhe mbeturinave jo të rrezikshme që vijnë nga praktikat e bujqësisë, blegtarisë, pylltarisë, dhe prodhimit të energjisë nga biomasa (Ligji Nr. 04 / L-060). Një nga objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës është të mbajë gjurmët e shpenzimeve të menaxhimit të mbeturinave dhe gjithashtu të stimulojë qytetarët e Kosovës që të paguajnë tarifën e mbeturinave me qëllim të financimit të

<sup>11</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. (2013). "Strategjia e Republikës së Kosovës Për Menaxhimin e Mbeturinave 2013 – 2022". Fq. 35. [http://mmph-rks.org/repository/docs/Strategjis%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Republik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosoves\\_per\\_Menaxhimi\\_n\\_e\\_Mbeturinave\\_-\\_alb\\_219608.pdf](http://mmph-rks.org/repository/docs/Strategjis%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosoves_per_Menaxhimi_n_e_Mbeturinave_-_alb_219608.pdf)

aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave. Tarifa e paguar për qytetarët duhet të jetë e barabartë me prodhimin e mbeturinave dhe shpenzimet e autoriteteve kompetente për shërbimet e ofruara. Në vitin 2015 Ministria e Financave (MF) e uli TVSH-në për disa shërbime komunale. Një nga këto shërbime publike përfshinte sektorin e mbeturinave me TVSH që u zvogëlua nga 16% në 8%. Megjithatë, nuk ka dëshmi të mjaftueshme nëse rritet ose zvogëlohet shuma e grumbullimit të tarifave në nivel komunal.

Ligji për mbeturinat thekson se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të sigurojë infrastrukturën e përshtatshme për menaxhimin e mbeturinave, duke filluar nga pajisjet e nevojshme apo teknologjia më e mirë e mundshme (BAT) për mbledhjen, transportimin, trajtimin dhe deponimit përfundimtar në mënyrë që të kontribuojë në një mjedis të qëndrueshëm. Sipas Ligjit Nr. 04/L-060, parimi “ndotësi pagan” i cili është në përputhje me rekomandimet e dhëna nga BE-ja, përcakton se për një person që është pjesë e zinxhirit të menaxhimit të mbeturinave duhet të ngarkohet për kostot totale dhe ndikimet e mundshme sociale të imponuara në mjedis, megjithëse nuk ka dëshmi të mjaftueshme se ky parim është i zbatueshëm në Kosovë.

Bazuar në prioritetet e reja të përcaktuara me Ligjin mbi Mbeturinat, Kosova duket se po pozicionohet më shumë drejt riciklimit dhe më larg nga deponimi. Prandaj, më shumë se kurrë prodhuesve vendas ju kërkohet të dizajnojnë dhe prodhojnë produkte ekologjike duke përdorur teknologji të prodhimi që mbështetet në riciklim. Mu për këtë, “parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit” definon obligimet e çdo prodhuesi ose zotëruesi të një të mire që synon të zvogëlojë vëllimin e prodhimit të mbeturinave, i cili është gjithashtu përgjegjës për mbajtjen dhe trajtimin e mbeturinave të krijuara gjatë gjithë ciklit të prodhimit deri në post-konsum. Megjithatë, Kosova ende mbetet prapa në praktikat themelore të riciklimit, siç janë projektet efektive ose pajisjet që promovojnë këtë iniciativë, dhe kërkesat e parashtruara nga parimi i fundit janë vështirë të përmbushura për një vend si Kosova. “Parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit” mbetet një sfidë e madhe e MMPH-së, zbatimi i të cilit parim është penguar nga MF-ja që justifikon këtë vendim duke përdorur pretekstin e buxhetit të ulët të Kosovës. Për këtë arsye, pasi MMPH nuk mund të përqendrohet në zbatimin e kësaj pjese të legjislacionit, së bashku me GIZ-in është duke synuar hartimin e “Ligjit mbi Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesve” dhe po konsideron vendosjen e një takse mbi produkte të cilat taksa do të variojnë në bazë të llojit të produktit. Sidoqoftë deri më sot, kjo mbetet një punë në progres.

Duke u bazuar në katalogun e klasifikimit të mbeturinave përpiluar nga BE, katalog i cili është miratuar edhe nga Kosova, mbeturinat mund të jenë: komunale, komerciale, industriale dhe medicinale. Siç u përmend në pjesën e parë të këtij punimi, duke marrë parasysh përbërjen e tij, mbeturinat mund të jenë të rrezikshme, jo të rrezikshme dhe inerte. Sipas ligjit për mbeturina, zotëruesi i mbeturinave duhet ta klasifikojë atë sipas kategorive të lartpërmendura. Por, shumë sektorë në Kosovë, si ai i

mjekësisë, nuk i kushtojnë shumë vëmendje mënyrës së hedhjes dhe aq më pak klasifikimit të mbeturinave, për shkak të mungesës së ndërtimit të vendeve speciale për deponim të llojeve të mbeturinave që ky sektor gjeneron. Për më tepër, mbeturinat kimike që vijnë nga minierat dhe industrinë e tjera të forta, kthehen në periudhën e para luftës që ende kërkojnë trajtim të veçantë e që kanë efekte negative si në mjedis ashtu edhe në shëndet të anëtarëve të komuniteteve. Në rastin e mbeturinave të rrezikshme të cilave nuk iu dihet burimi i gjenerimit, shpenzimet e pastrimit janë obligim i MMPH-së. Prandaj, ligji mbi mbeturinat i jep kompetenca ministrive në lidhje me hartimin e planit dhe ndërtimit të strategjisë të menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme.

Për më tepër, Programi IPA II 2015-2017 liston ndërtimin e vendeve të magazinimit për Materialet e Mbeturinave të Rrezikshme si një nga prioritetet kryesore e që përfshinë mbeturinat e nxjerra nga dekomisionimi i TC Kosova A dhe prodhimet e tjera industriale në Kosovë. Projekti me titull "Inventar i mbeturinave të rrezikshme në Kosovë" është përfshirë në Strategjinë e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022 dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, e cila deri tani ka hartuar statusin dhe hierarkinë e menaxhimit të mbeturinave. Në mënyrë që ky projekt të realizohet, pritet që qeveria e re ta miratojë atë dhe ta rrisë buxhetin që shkon në kuadër të investimeve. Por kjo mbetet një sfidë pasi MMPH dhe institucionet e tjera përgjegjëse nuk kanë të dhëna të përgjithshme për sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Për më tepër, ministrinë mund të krijojnë bashkëpunime ndërkomunale. Megjithatë, gjatë hartimit të këtij lloji plani duhet të ketë një sasi dhe lloj të caktuar mbeturinash që mund të gjenerohen, grumbullohen, transportohen dhe deponohen. Ministrinë janë gjithashtu përgjegjëse për hartimin e programeve për grumbullimin e mbeturinave shtëpiake, biznesore dhe industriale dhe riciklimin potencial. Sikurse me ministrinë, nëse burimi i gjenerimit të mbetjeve është i panjohur dhe zhvillohet në hapësirat publike, atëherë komuna është përgjegjëse për pastrimin e kësaj hapësire. Për të kontrolluar aktivitetet e ushtruara nga pjesëmarrësit e menaxhimit të mbeturinave, komuna u jep të drejtë inspektorëve në mënyrë që detyra e tyre kryesore të jetë mbikëqyrja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe saktësia në kushtet e licencave. Kështu që kurdoherë që ndodh ndonjë shkelje e ligjit, atëherë inspektori komunal mund të ngarkojë ndëshkim për personin fizik apo juridik.

Ligji për mbeturinat gjithashtu vë në pah përgjegjësitë e zotëruesit të mbeturinave dhe zinxhirin e pjesëmarrësve deri tek prodhuesi, importuesi dhe eksportuesi, procesori, transportuesi dhe së fundmi ai që hudh mbeturinën. Mbeturinat nuk mund të kalohen në palën tjetër pa qenë palë aktuale e licencuar. Sipas ligjit, mbeturinat duhet të trajtohen siç parashikohet nga hierarkia e menaxhimit të mbeturinave. Kur mbeturinat e rrezikshme, jo të rrezikshme dhe inerte arrijnë në fazën përfundimtare, atë të hudhjes, ato duhet të vendosen në deponitë e tyre përkatëse. Sa i përket mbeturinave të rrezikshme, është e ndaluar me ligj që të hudhen pa një trajtim paraprak. Për më

tepër, ky lloj i mbeturinave ndalohet të importohet brenda Kosovës. Kërkesa e njëjtë është e zbatueshme për mbeturinat si nafta, bateritë, elektronikën, gomat, automjetet, tubat fluoeshente, mbetjet nga ndërtimi dhe prishja e objekteve, biodegraduesit, paketimit dhe ambalazhimit, llumit etj. Të gjithë këto kanë nevojë për trajtim të veçantë përpara se të hudhen në deponi.

Bazuar në Strategjinë e Menaxhimit të Mbeturinave të Republikës së Kosovës 2013-2022, keqmenaxhimi i këtij sektori ka shkaktuar pasoja të rënda në ajër, tokë, ujë (sidomos në ujëra nëntokësore) dhe shëndet publik<sup>12</sup>. Qëllimet e vendosura të strategjisë për periudhën 10 vjeçare janë rritja e kapaciteteve të grumbullimit të mbeturinave që nuk është parë të ndodh deri tani. Për më tepër, ajo parashikoi që sistemi aktual do të përmirësohet, megjithatë autoritetet tona qeverisëse nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet sa i përket përmbushjes së këtij qëllimi.

Një nga objektivat e strategjisë është edukimi i publikut në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Për të marrë rezultate të mëdha në krijimin e një menaxhimi të qëndrueshëm të mbeturinave, ka nevojë për palët e interesuara të përmendura më parë që të marrin iniciativa për edukimin e brezave të rinj në mbrojtjen e mjedisit. Është e rëndësishme që të personalizohen përfitimet, për shembull, duke demonstruar përfitimet që do të rrjedhin në drejtim të përmirësimit të shëndetit publik. Përveç edukimit të publikut, trajnimet e ofruara për personelin që punojnë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave do të japin rezultate të mira në përmirësimin e situatës aktuale të sektorit. Prioritetet e kësaj strategjie janë zvogëlimi i sasisë së mbeturinave të krijuara, i cili vëllim është zvogëluar në 5 vitet e fundit. Në vitin 2010, u vlerësua se sasia e mbeturinave të grumbulluara ishte 395,000 ton<sup>13</sup>, ndërsa në vitin 2015 u reduktua për 75,966 ton<sup>14</sup>. Sipas përfaqësuesve të MMPH-së, 650-700 gram mbeturina për kokë banori gjenerohen në vitin e fundit. Këto informata u dhanë nga organizatat ndërkombëtare, si JICA dhe USAID, të cilët kanë qenë donatorë të shpeshtë të sektorit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Megjithatë, ky informacion është kontestuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, pasi të dhënat e fundit të marra nga terreni tregojnë se mbeturinat e gjeneruara për kokë banori arrijnë në 900 gr. Megjithatë, MMPH preferon të besoj më tepër në kredibilitetin e organizatave ndërkombëtare të lartpërmendura, pavarësisht faktit se ASK-ja është një nga institucionet zyrtare përgjegjëse për publikimin e të dhënave statistikore për Kosovën<sup>15</sup>.

---

<sup>12</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. (2013). 'Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013 - 2022'. Qeverija e Republikës së Kosovës. Fq. 8. [http://mmp-h-rks.org/repository/docs/Strategjis%C3%AB\\_s%C3%AB\\_Republik%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Kosoves\\_per\\_Menaxhimi\\_n\\_e\\_Mbeturinave\\_-\\_alb.\\_219608.pdf](http://mmp-h-rks.org/repository/docs/Strategjis%C3%AB_s%C3%AB_Republik%C3%ABs_s%C3%AB_Kosoves_per_Menaxhimi_n_e_Mbeturinave_-_alb._219608.pdf)

<sup>13</sup> The World Bank. (2013). "Kosovo Country Environmental Analysis". Fq. 37.

<http://documents.worldbank.org/curated/en/282361468047686579/pdf/750290ESWOP1310LIC00KosovoOCEA0Rprt.pdf>

<sup>14</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2015). "Anketa e Mbeturinave Komunale 2015". Fq. 8. <http://ask.rks-gov.net/media/2492/anketa-e-mbeturinave-komunale-2015.pdf>

<sup>15</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). 'Ligji Nr. 04/L-036 Për Statistikat Zyrtare Të Republikës Së Kosovës'. Neni 5. <http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf>

Kosova është e njohur për sfidat e vazhdueshme mjedisore që lidhen me sektorin e energjisë, për shkak të ndotjes së ajrit të shkaktuar nga TC Kosova A dhe Kosova B. Një nga premtimet që dalin nga strategjia është përdorimi i mbeturinave për prodhimin e energjisë, i cili ngjashëm me riciklimin duket se nuk është përmbushur dhe nuk është iniciuar nga autoritetet në Kosovë. Së fundmi, mbeturinat jo të riciklueshme duhet të hidhen në mënyrë efikase dhe që mbron mjedisin. Gjatë dekomisionimit të Kosovës A, mbeturinat që do të gjenerohen nga ky proces kanë nevojë për një planifikim strategjik për mënyrën adekuate dhe specifike të trajtimit të tyre. Me qëllim të implementimit sa më të mirë të mundshëm të ligjit aktual mbi mbeturinat, qeveria vendosi prioritetet për sektorin e menaxhimit të mbeturinave të cilat janë në sinkronizim me ligjet e BE-së dhe Kosovës për mbeturina, të cilat janë:

- Rritja e vetëdijesimit për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht për menaxhimin e mbeturinave,
- Parandalimi i krijimit të mbeturinave të tepërta, rehabilitimi i vendeve të dëmtuara nga aktivitetet aktuale të sektorit,
- Zvogëlimi i epidemive dhe kontaminimit të burimeve të jetës (ajri, uji dhe toka), rritja e kapaciteteve për prodhimin e energjisë që vjen nga mbeturinat, riciklimi, ndërtimi i hapësirave të jetesës që trajtojnë në mënyrë efikase mbeturinat,
- Investimi në shërbimet e grumbullimit dhe zonat e tyre,
- Krijimi i deponive që janë të pranueshme për mjedisin,
- Monitorimi i aktiviteteve të pjesëmarrësve në menaxhimin e mbeturinave,
- Ngritja e tarifave për ekonomitë familjare dhe bizneset që operojnë me shërbimet e tyre në menaxhimin e mbeturinave.

## Korniza Institucionale e Menaxhimit të Mbeturinave




Fig. 1. Organogrami i Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave

Korniza institucionale e menaxhimit të mbeturinave fillon me asamblenë që është përgjegjëse për hartimin e ligjeve, në këtë rast ligji dhe strategjinë mbi mbeturinat. Detyra e asamblesë është të monitorojë nëse implementimi i ligjit është duke u ekzekutuar ashtu siç duhet. Sa i përket qeverisë, ajo miraton strategjinë mbi mbeturinat e propozuar nga asambleja. Pastaj, MMPH-ja harton legjislacionin dhe strategjinë, harton programe monitorimi për hisedarësit e sektorit të menaxhimit të mbeturinave, përpilon dhe publikon të dhëna në terren për situatën aktuale të mbeturinave etj. Për më tepër, MMPH-ja vendos stacionet e mbeturinave dhe përcakton shumën e pagesës për deponim. Sa i përket MZHE-së, përgjegjësitë e kësaj ministrie janë të rregullojnë procedurën e emërimit të ndërmarreve publike dhe t'i kontrollojnë ato, ku si i tillë mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes. Ekzistojnë ministri të tjera që janë të përfshirë në çështjen e mbeturinave, si MSH-ja të cilët janë përgjegjës për mbeturinat medicinale, MTI përgjegjëse për mbeturinat industriale dhe së fundmi MB përgjegjëse për mbeturinat bujqësore. Sidoqoftë, më problematiket mbeten mbeturinat industriale sepse objektet që prodhojnë mbeturina industriale mund të gjenerojnë edhe mbeturina apo substanca të tjera.



Pas hartimit dhe miratimit të legjislacionit, komunat dizajnojnë planet e menaxhimit të mbeturinave. Komunat, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në zinxhirin e menaxhimit të mbeturinave sidomos për mbeturinat komunale, janë të detyruar të sigurojnë infrastrukturë për sektorin e mbeturinave, të punësojnë personel të trajnuar dhe me ekspertizë në këtë fushë, dhe të përcaktojnë hierarkinë ku çdo nivel do t'i ketë të përcaktuara kompetencat dhe përgjegjësitë e personelit përkatës. Për më tepër, ata duhet të respektojnë legjislacionin dhe ta implementojnë atë në mënyrë korrekte. Duke ndërmarrë masa të ndryshme, ata mund të krijojnë dhe të stimulojnë qytetarët për të menaxhuar siç duhet çështjen e deponimit duke ndryshuar shprehitë e tyre në raport me mjedisin. Ata duhet të monitorojnë të dy sektorët, atë publik dhe privat, dhe të kontrollojnë nëse ato operojnë në përputhje me rregullat dhe gjithashtu të identifikojnë pjesëmarrësit e sektorit informal në menaxhimin e mbeturinave. Komunat janë ato që mund të kontraktjnë kompanitë private të licencuara për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, duke filluar nga grumbullimi deri në hudhjen përfundimtare të mbeturinave. Prandaj, komunat duhet të monitorojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga këto kompani dhe të kontrollojnë nëse ato shërbime janë në përputhje me standardet e caktuara të cilësisë. Në këtë rast, rritet nevoja për asistencë dhe ndihmë nga hisedarësit e tjerë, përkatësisht Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), institucioni i cili është përgjegjës për mbështetjen e ofrimit të shërbimeve efektive dhe të përshtatshme të menaxhimit të mbeturinave për qytetarët.

Meqënëse shumica e mbeturinave në Kosovë përfundojnë nëpër deponi, ekziston nevoja që një institucion të mbikëqyrë dhe menaxhojë këto deponi. Për këtë arsye KMDK kujdeset për deponitë komunale. Kompanitë rajonale apo publike janë gjithashtu pjesëmarrës në menaxhimin e mbeturinave. Ata luajnë një rol të rëndësishëm në grumbullimin e mbeturinave në zonat urbane dhe rurale dhe ndonjëherë jo vetëm në një komunë, por edhe për ato që gjeografikisht gjenden afër njëra-tjetrës dhe nuk u ofrojnë qytetarëve shërbime të menaxhimit të mbeturinave. Këto kompani rajonale janë të vendosura kryesisht në qytetet e mëdha të Kosovës. Tabela më poshtë lidh kompanitë rajonale në komunat e tyre përkatëse në të cilat ata veprojnë.

<b>Kompanija Regjonale</b>	<b>Komuna</b>
KRM - Pastrimi	Prishtine
KRM Ekoregjioni	Prizren
KRM- Eco-Higjiena	Gjilan
KRM- Pastërtia	Ferizaj
KRM-Çabрати	Gjakove
KRM - Ambienti	Peje

KRM - Uniteti	Mitrovica
KRM - Standard	Mitrovica
Kompania e Mbeturinave Zvecan	Zvecan
Kompania e Ujesjellesit dhe Mbeturinave Ibri	Zubin Potok
Kompania e Ujesjellesit dhe Mbeturinave 24 Nentori	Leposaviq
Komuna Klllokot	Klllokot
Komuna Partesh	Pasjan-Partesh
Komuna Ranillug	Ranillug

Tab. 2. Lista e Kompanive Regjionale/Publike

Komunat veriore të Kosovës si Mitrovica, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, të cilët kanë menaxhimin e mbeturinave të tyre të themeluara nga komuna paralele serbe dhe që monitorohen nga anëtarët e bordit që veprojnë nën Qeverinë e Republikës së Serbisë, përbëjnë një sfidë tjetër për sektorin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Sa i përket ofrimit të informacionit mbi situatën e menaxhimit të mbeturinave, Agjencia Kosovare e Mbrojtjes së Mjedisit (AKMM) është përgjegjëse për informacionin e të dhënave dhe publikimin e raportit mbi këtë sektor.

Edhe pse nuk janë të listuar si hisedarësit kryesorë në organogramin e paraqitur më lart, publiku, planifikuesit urbanë, OJQ-të, institucionet arsimore, spitalet, industritë dhe korporatat (si ndotës) luajnë një rol kyç në çështjen e menaxhimit të mbeturinave. Për shembull, obligim i publikut pritet të jetë kontributi i dhënë në uljen e sasisë të prodhimit të mbeturinave, të bashkëpunojnë me organet qytetare dhe të identifikojnë vendet e hudhjes së mbeturinave (ligjshme dhe të paligjshme) dhe të marrin pjesë rregullisht duke paguar faturën për shërbimet e marra nga kompanitë publike dhe private në komunën e tyre përkatëse. Një nga detyrat kryesore kur është fjala për çështjen e deponimit të mbeturinave ka të bëjë me planifikuesit urbanë të cilët duhet të bëjnë përcaktojnë saktë lokacionet e deponive gjatë hartimit të planit të qytetit. Përveç marrjes së vendimeve për lokacionet e deponive, ata gjithashtu duhet të gjejnë objektet që janë pjesë e menaxhimit të mbeturinave sa më afër këtyre zonave.

Sa i përket shoqërisë civile, ata duhet të sigurohen që të marrin pjesë në çështje që kanë ndikim në gjithë komunitetin. Ata mund të ngrenë zërin e tyre në lidhje me shqetësimet e qytetarëve, të mbështesin dhe të kontaktojnë autoritetet lokale, të organizojnë fushata sensibilizuese për problemet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe në të njëjtën kohë të bashkëpunojnë me OJQ-të e tjera dhe të përpiqen të zbusin pasojat e aktiviteteve joadekuate të menaxhimit të mbeturinave. Por, përveç OJQ-ve, institucionet arsimore mund të diskutojnë tema të ndryshme mbi zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit duke u dhënë mësim brezave të ri se si të mbrojnë mjedisin në të cilin jetojnë. Së fundi, industritë e forta, korporatat dhe sektori mjekësor të cilat janë disa nga ndotësit më

të mëdhenj që gjenerojnë mbeturina të rrezikshme për shkak të natyrës së praktikave të tyre të punës janë gjithmonë në shënjestër për të ulin prodhimin e mbeturinave. Për shkak se ata hudhin sasi të mëdha të mbeturinave që mund të jenë fatale për mjedisin dhe njerëzit, autoritetet duhet me kujdes të veçantë të përcaktojnë vendndodhjen e deponive dhe mënyrat e hudhjes së mbeturinave për këta sektorë.

## Burimet Financiare të Sektorit të Menaxhimit të Mbeturinave

Ndihma e BE-së për shtet formimin e Kosovës ka marrë forma të ndryshme. Siç u përmend më herët, një prej objektivave të saj për Kosovën ishte të mbështeste zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor. Kosova nuk trajton siç duhet mbeturinat jorrezikshme. Nga të dy kategoritë e mbeturinave, shumica e gjeneruar për mbeturinat jo të rrezikshme është 97%, ndërsa të rrezikshme vetëm 3%<sup>16</sup>. Si në aspektin e gjenerimit të mbeturinave komunale, sipas ASK-së, të dhënat e tyre të fundit që datojnë në vitin 2015 tregojnë se shumica e gjeneruar ishte 319,034 ton<sup>17</sup>. Përderisa situata nuk është e favorshme në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, autoritetet lokale janë më shumë se kurrë të gatshme dhe të hapura për të bashkëpunuar me organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare në këtë drejtim. Qeveria e Republikës së Kosovës i dedikon një pjesë të buxhetit të vet drejt menaxhimit të mbeturinave por sidoqoftë nuk është në gjendje të mbulojë të gjitha shpenzimet e saj pa një mbështetje financiare nga organizatat ndërkombëtare. Ndërsa duke marrë parasysh vlerën monetare të dedikuar për sektorin e menaxhimit të mbeturinave përgjatë viteve, buxheti kombëtar ndan një pjesë të mirë të financimit për këtë sektor megjithatë shumë pak bëhet në krijimin e një infrastrukture dhe menaxhimi të mirëfilltë. Si i tillë, shumica aktuale e alokuar për mbeturinat në vitin 2016 ishte 9,816,400 EUR<sup>18</sup>, ndërsa është vlerësuar se shumica për vitin 2017 do të jetë rreth 2,910,000 EUR<sup>19</sup>. Por në buxhetin kombëtar për vitin 2017, shpenzimet e tilla janë më të larta, përkatësisht 3,397,814 EUR<sup>20</sup>. Kur bëhet fjalë për grumbullimin e fondeve për menaxhimin e mbeturinave, komunat mund ta bëjnë këtë në mënyra të ndryshme; për shembull fondet e siguruar nga buxheti i komunës, të ardhurat nga taksat e grumbulluara nga ekonomitë familjare dhe bizneset, donacionet, masat ekonomike (siç janë tatimet e vendosura mbi importet, produktet etj). Motivi kryesor pas këtyre fondeve është që ato të përdoren për krijimin e një menaxhimi të qëndrueshëm ekologjik të mbeturinave. Në vitet e fundit, ka pasur një interes të shtuar në promovimin e riciklimit në Kosovë, veçanërisht nga ekspertët e huaj. Për shembull,

---

<sup>16</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2016). "Anketa e Mbeturinave Industriale 2015". Fq. 8. <http://ask.rks-gov.net/media/2619/anketa-e-mbeturinave-industriale-2015.pdf>

<sup>17</sup> Fq. 8.

<sup>18</sup> Ministria e Financave. (2015). 'Buxheti i Kosoves per vitin 2016'. Fq. 24. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11324>

<sup>19</sup> Fq. 24.

<sup>20</sup> Ministria e Financave. (2016). 'Buxheti i Kosoves per vitin 2017'. Fq. 33. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13230>

në vitin 2016, një ndihmë financiare i është dhënë Kosovës nga Qeveria e Francës për të përmirësuar trajtimin e ujërave të zeza në Kosovë. Nga viti 2014 deri më tani, mbështetja financiare e dhënë Kosovës nga BE vetëm për menaxhimin e mbeturinave arrin në 1,052,830 EUR<sup>21</sup>, ndërsa ndihma e përgjithshme financiare është e barabartë me 645.5 milionë EUR<sup>22</sup> për një periudhë 6 vjeçare. Ndërsa ndihmat që vijnë nga donatorë të tjerë ndryshojnë, për shembull, Gjermania ka dhënë 2,000,000 EUR<sup>23</sup>, Japonia ka dhënë 154,425 EUR<sup>24</sup>, ndërsa Zvicra ka dhënë 8,000,000 EUR<sup>25</sup> vetëm për një projekt që po zhvillohet në Gjakovë.

## Vështrim i Praktikave Aktuale të Menaxhimit të Mbeturinave në Kosovë

Sfidat mjedisore në Kosovë kanë qenë evidente gjatë viteve të cilat nëse nuk bëhen më të rënda, as nuk përmirësohen as nuk shënojnë ndonjë progres të prekshëm në adresimin e tyre. Pamundësia për të arritur objektivat e BE-së në lidhje me mbeturinat vjen si pasojë e mungesës së vullnetit politik, mungesës së zbatimit të ligjit dhe mos prioritizimi i problemeve mjedisore, mungesës së ekspertizës së punëtorëve të këtij sektori dhe burimeve të pamjaftueshme financiare janë disa nga arsyet që kontribuojnë në përkeqësimin e situatën aktuale në Kosovë lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Megjithatë, përgjegjësia e përmirësimit të situatës së mbeturinave nuk bie vetëm në sektorin publik, por edhe në ndërmarrjet private që janë palë me interes në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat kompanitë deri në kohën e hyrjes së Kosovës në BE duhet gjithashtu të jenë në përputhje me rregulloret strikte që ky sektor mban.

Si shteti më i ri evropian, Kosova është monitoruar në aspekte të ndryshme shtetërore nga BE-ja; asistencë kjo e cila shihet si shumë e vlefshme për të ndërtuar një shtet të qëndrueshëm. Sipas MMPH-së, situata e mbeturinave duket se është përmirësuar, por jo në mënyrë substanciale, prandaj Kosova ende ka shumë për të bërë që të krijojë një mjedis të qëndrueshëm. Në vitin 2014, MMPH ishte angazhuar shumë në hartimin e një strategjie për menaxhimin dhe mbledhjen e mbeturinave. Gjatë gjithë këtyre viteve, ky institucion ka rekomanduar gjithashtu që zgjidhja më e mirë për sektorin e menaxhimit të mbeturinave të përfshijë vetëm kompanitë private; kjo ende mbetet mjaft problematike edhe sot.

---

<sup>21</sup> Kalkulime të autorit.

<sup>22</sup> European Bank for Reconstruction and Development. (2016). 'Strategy for Kosovo'. Fq. 18. [www.ebrd.com/downloads/country/strategy/kosovo-strategy.pdf](http://www.ebrd.com/downloads/country/strategy/kosovo-strategy.pdf)

<sup>23</sup> Ministria e Integritit Europian. (2016). 'Donor Profile'. Fq. 27. [http://www.mei-ks.net/repository/docs/annualreport\\_donorprofiles\\_printready.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/annualreport_donorprofiles_printready.pdf)

<sup>24</sup> Fq. 30

<sup>25</sup> Swiss Cooperation Programme in Kosovo. (2015). 'Democratic Governance and Decentralization'. Fq. 7. [https://www.eda.admin.ch/content/dam/countries/countries-content/kosovo/en/Project-list-February-2015-update\\_EN.pdf](https://www.eda.admin.ch/content/dam/countries/countries-content/kosovo/en/Project-list-February-2015-update_EN.pdf)

Një mënyrë e zakonshme e asgjësimit të mbeturinave në Kosovë është ajo e deponimit, por për shkak se deponitë janë të kapacitetit të ulët dhe mungojnë investimet e duhura, jo të gjitha komunat kanë një zonë përkatëse të deponimit që i shtyu ato të bashëpunonin me komunat e tjera. Për këtë arsye, Komisioni i BE-së përmes Raportit të Progresit për vitin 2014 dhe 2016 deklaroi se MMPH-ja duhet të fillojë të inkurajojë riciklimin, në mënyrë që jetëgjatësia e deponive të rritet<sup>26</sup>. Përkundër promovimit të saj, pati mungesë investimesh pasi që Kosova nuk ishte në objektivat e investitorët. Prandaj, autoritetet lokale duhet të bëjnë shumë punë drejt tërheqjes së investitorëve të objekteve të riciklimit dhe duke krijuar kushte të favorshme për ta. Nëse asgjë nuk bëhet në lidhje me riciklimin ose ndërtimin e deponive të reja, deponitë janë në gjendje të marrin mbeturina vetëm për 2 deri në 3 vitet e ardhshme.<sup>27</sup>

Sipas MMPH-së, legjislacioni është afëruar shumë me Direktivat e BE-së. Kjo kornizë ligjore përbëhet nga ligji për mbeturinat, 29 udhëzime administrative dhe 1 rregullore (shih shtojcën). Sidoqoftë, një problem i madh mbetet zbatimi i pjesshëm i tyre nga institucionet, veçanërisht kur bëhet fjalë për mbeturinat komunale. Në vitin 2012, duke synuar përmirsimin e situatës aktuale, përgjegjësia e mbeturinave komunale dhe përcaktimi i tarifave l'u deleguan komunave, vendim ky i cili decentralizoi sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Megjithatë, jo të gjitha komunat janë të njëjta, siç është Prizreni, i cili është mbështetur fuqishëm nga JICA gjatë viteve të fundit dhe ka themeluar një sektor të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave që respekton të gjitha direktivat, ka vendosur tarifën e veta dhe mbledh rregullisht me publikun dhe sektori privat i përfshirë. Përveç zbatimit të ligjit, komuna përkatëse ka krijuar një njësi të caktuar funksionale që merret veçanërisht me mbeturinat komunale; një njësi që secila komunë kërkohet të krijojë nga MMPH, por vetëm disa prej tyre kanë bërë deri tani.

Me qëllim që të inkurajohen komunat tjera që të ndjekin të njëjtin shembull si atë të komunës së Prizrenit, MMPH-ja në bashkëpunim me GIZ-in kanë organizuar garën "Mjedisi i Pastër" në të cilën morën pjesë 17 komuna<sup>28</sup>. Ky projekt përfshinte 7 kompani të mbeturinave dhe 69% të popullsisë. Kusht për të qenë i kualifikuar për të hyrë në garë ishte të zotëronte një plan komunal për menaxhimin e mbeturinave, i cili stimulonte ata që nuk e kishin një të tillë të përpilonin atë, pasi që performuesi më i mirë do të fitonte një investim me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve që kontribuojnë në një mjedis më të qëndrueshëm. Rezultatet ishin mjaft të dëshirueshme përderisa rrjeti i shërbimit të

---

<sup>26</sup> Komisioni Evropian. (2014). "Raporti i Progresit 2014 Për Kosovën\*". Fq. 49. [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final\\_20141008-kosovo-progress-report\\_en\\_\(2\).pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_(2).pdf)

<sup>27</sup> Haxhiu, A. Kompania e Menaxhimit të Deponive të Kosovës. Intervistë. 12 Shtator 2017.

<sup>28</sup> Balaj, I. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Intervistë. 22 Gusht 2017.

mbeturinave u zgjerua për 11%, mbledhja e tarifave për shërbimet e grumbullimit të mbetjeve u rrit për 5%, numri i deponive ilegale u zvogëluar për 35% dhe së fundmi, por jo më pak i rëndësishëm, filloi krijimi i strukturave themelore të qeverisjes lokale në komunat pjesëmarrëse.

Pasi që Kosova mbetet prapa në grumbullimin e duhur të mbeturinave, prioritet kryesor i MMPH-së është që të përmirësohet ky aktivitet duke ndihmuar gjerësisht këtë fragment të menaxhimit të mbeturinave. Për këtë arsye, MMPH shpesh organizon fushata për rritjen e vetëdijesimit, si mbajtja e punëtorive në shkollat publike me tema se si të ulet niveli i gjenerimit të mbeturinave, ku grupi i targetuar janë gjeneratat e reja. Zgjidhjet e mundshme që MMPH-ja konsideron të ndërmarrë për të lehtësuar pasojat e sektorit janë sanksionimi, subvencionimi i sektorit dhe krijimi i një inspektoriatit<sup>29</sup>. Për më tepër, komunat duhet të jenë më të rrepta në aspektin e cilësisë së shërbimeve që vijnë nga menaxhimi i mbeturinave të ofruara nga kompanitë, qofshin ato publike ose private, në cilin rast ky i fundit (i drejtuar nga fitimi) duhet të monitorohet për së afërmi në mënyrë që të mos ketë keqpërdorime.

Në përgjithësi, 60% e qytetarëve të Kosovës janë të pajisur me shërbime themelore të menaxhimit të mbeturinave, ndërsa vetëm 70% e atyre marrësve të shërbimeve i paguajnë faturat këtij sektori<sup>30</sup>. Ky nivel i ulët i mbledhjes së faturave përbën një problem serioz për kompanitë publike dhe private sa i përket mbulimit të kostove të veprimit, por edhe për të gjithë sektorin që e pengon atë të investojë në projekte efektive. Sipas kryetarit të komunës së Prishtinës, duke filluar nga janari 2018, faturat e mbeturinave do të mblidhen së bashku me tatimin në pronë<sup>31</sup>. Me fjalë të tjera, qytetarët do të paguajnë tarifën e mbeturinave në komunë dhe jo në kompaninë rajonale 'Pastrimi'. Meqënëse ky i fundit është kontraktuar për të mbledhur mbeturinat nga kontenjerët e mbeturinave në komunë, pjesë të konsiderueshme të qytetit mbeten të ndotura pasi që mbeturinat hudhen edhe jashtë kontenjerëve. Prandaj duke paguar faturën e mbeturinave direkt në komunë, komuna do të ndahet në zona në mënyrë që pjesët e prekura të pastrohen gjithashtu. Për më tepër, pagesat do të kontribuojnë në krijimin e një plani të ri të duhur dhe plan logjistik për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës.

Ky vendim erdhi si pasojë e pamundësisë së kompanive për të marrë pagesa nga klientët e tyre, përkatësisht ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet, të cilat krijojnë një problem tjetër mjedisor, i cili është ai i krijimit të deponive ilegale. Pothuajse 30% e mbeturinave të gjeneruara hudhen në deponi ilegale dhe grumbullohen nga sektori joformal, por pasi që prodhuesi i mbeturinave është i panjohur në këtë rast, për autoritetet qeverisëse kjo mbetet një fragment i paarrtshëm dhe i

---

<sup>29</sup> Intervistë. 22 August 2017.

<sup>30</sup> Intervistë. 22 August 2017.

<sup>31</sup> Ahmeti. Sh. (2017, September). The Business of Waste Recycling and Green Jobs Opportunities in Kosovo. Panel Discussion in Second Green Festival, Pristina, Kosovo.

pakontrolluar i menaxhimit të mbeturinave<sup>32</sup>. Sidoqoftë, hudhja e paligjshme nuk kryhet vetëm nga individë, por edhe nga kompanitë private. Ndërsa kompanitë mbledhëse dërgojnë mbeturinat e grumbulluara për deponim përfundimtar në zona të veçanta komunale, ata duhet të paguajnë një tarifë të caktuar për ton të mbeturinave. Prandaj, në mënyrë që të ulin kostot e tyre ata kanë tendencë për të shmangur pagesën e tarifës së deponimit duke hudhur mbeturinat në deponi ilegale.

Kur është fjala për tarifën e deponimit të mbeturinave, është një debat i vazhdueshëm që zhvillohet ndërmjet KMDK-së dhe MMPH-së, pasi që sipas institucionit të parë kjo tarifë është shumë e ulët. Kjo tarifë për një kohë të gjatë ka qenë 5.31 € që nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kompanive<sup>33</sup>. Të gjitha këto katër deponi u financuan nga Agjencia Evropiane për Zhvillim dhe në atë kohë ekspertët ndërkombëtarë konsideruan se niveli i çmimeve për tarifën e deponisë duhet të jetë 8.60 €, pa përfshirë TVSH-në. Por, për fat të keq, me ngritjen e nivelit të gjenerimit të mbeturinave hisedari kryesor, përkatësisht qeveria krahas ZRRUM, uli tarifën në 5.26 € pa marrë parasysh faktorët që ndikojnë në shpenzimet shtesë që nevojiten për trajtimin e mbeturinave të gjeneruara. Ndërmarrja qendrore publike, KMDK, ka parashtruar ankesë për rritjen e kësaj tarife, me ç'rast është ngritur vetëm 0.06 cent.

Pas kësaj, ankesat e tyre për rritjen e tarifës mezi morën përgjigje. Sipas Njesisë për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, departament në MZHE, deklaroi se për shkak të standardeve të ulëta në Kosovë dhe mirëqenies sociale, kjo tarifë nuk u rrit sepse përveç rritjes së shpenzimeve të kompanive grumbulluese, konsumatorët do të pësonin më së shumti<sup>34</sup>. Përveç kësaj, u pretendua që qeveria të mbulojë shpenzimet tjera të KMDK-së, pjesëmarrja e së cilës zgjati vetëm për 1 ose 2 vjet dhe pastaj u ndal pas vitit 2015<sup>35</sup>.

Megjithatë, për të parandaluar hudhjen ilegale, ndëshkimet duhet të zbatohen nga inspektorët në terren. Edhe pse ligji mbi mbeturina miraton ndëshkimet, MMPH-ja dhe inspektoratet komunale nuk kanë personel të mjaftueshëm dhe resurse, ndërsa vlera monetare e ngarkuar mbi personi fizik apo juridik është shumë e ulët. Pasi që shumica e komunave nuk kanë një inspektorat funksional për mbeturinat, MMPH-ja sugjeron shumë krijimin e entiteteve të tilla. Për më tepër, rastet që shkojnë deri në gjykatë nuk shqyrtohen kurrë nga personat gjyqësor pasi që nuk konsiderohet të jetë prioritet duke marrë parasysh rastet e tjera.

Ashtu siç u tha më parë, pengesat në lidhje me menaxhimin e mbeturinave në Kosovë përfshijnë mungesën e zbatimit të ligjit për mbeturinat dhe investimet, politikat joefektive dhe të padefinuara, mungesën e inspektimit, shprehitë e papërshtatshme të publikut etj. Gjithashtu sektori mbetet prapa

---

<sup>32</sup> Balaj, I. Ministry of Environmental and Spatial Planning. Personal communication. 22 August 2017.

<sup>33</sup> Haxhiu, A. Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës. Intervistë. 12 Shtator 2017.

<sup>34</sup> Spahiu, F. Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Intervistë. 22 Shtator 2017.

<sup>35</sup> Haxhiu, A. Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës. Intervistë. 12 Shtator 2017.

në riciklim pasi aktualisht vetëm 32% e mbeturinave në Kosovë janë të riciklueshme, por vetëm 5% janë duke u trajtuar si të tilla. Përbërja e mbetur e mbeturinave përbëhet nga 40% biodegradable dhe pjesa tjetër është mbetje të tjera<sup>36</sup>. Problemi i mbeturinave komunale merr intenzitet edhe më të madh gjatë sezonit të verës, kur temperaturat janë të larta dhe ato kontribuojnë në krijimin e aromave të këqija rreth hapësirave të jetesës dhe rritjes së toksinave dhe sëmundjeve. Prandaj, zhvillimet e planeve të reja efektive që nxisin ekonominë qarkulluese jo vetëm që sjellin përfitime për mjedisin, por edhe për ekonominë dhe aspektin social të qytetarëve. Prandaj, inkurajimi i aktiviteteve të riciklimit është një nga qëllimet kryesore të ndihmës së Gjermanisë në komunat e Kosovës. Vetëm pak kohë më parë, ky shtet anëtar i BE-së i dedikoi Kosovës një fond prej 3.4 milionë EUR, të cilat depozita do të përdoren për ndërmarrjet publike për përmirësimin e pajisjeve, kontenjerëve dhe veshjeve të punonjësve etj., pasi ato janë aktualisht të përkeqësuar<sup>37</sup>.

Kosova ka pasur vështirësi në menaxhimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të gjeneruara. Sektori formal, i përbërë nga kompanitë publike dhe private, është përgjegjës për mbledhjen, transportimin dhe deponimin e mbeturinave. Megjithatë, pasi që sektori joformal ka funksionuar gjerësisht për disa vite në menaxhimin e mbeturinave, ato shkaktojnë sfida të reja për sektorin formal. Për shembull, sektori joformal punon ngushtë me bizneset e vogla që të cilat synojnë profitin në vend që të ushtrojnë aktivitetet e tyre për hir të përfitimeve mjedisore. Ky sektor përbëhet kryesisht nga komuniteti pakicë RAE. Edhe ky fakt ka qenë i dukshëm në komunën e Obiliqit, ku sektori joformal ka ndihmuar shumë në përmirësimin e situatës së menaxhimit të mbeturinave brenda komunitetit, grumbullimi i të cilave përfundon në njërën nga kompanitë më të mëdha të komunës, e cila riciklon materiale, veçanërisht plastike, kanaqe dhe skrap<sup>38</sup>. Brenda këtij grupi, puna e fëmijëve është shumë e zakonshme që kushtet e punës janë të pafavorshme dhe përfshijnë rrezik të lartë për jetë.

Sektori joformal ka dy mënyra të mundshme për gjenerimin e të ardhurave dhe ato janë duke shitur mbeturinat e mbledhura të riciklueshme për kompanitë e vogla me një çmim të caktuar ose mund të punësohen pjesëtarët e minoriteteve që mbledhin këso lloj mbeturinash. Por gjatë aktiviteteve të grumbullimit të tyre në pikat e grumbullimit të mbeturinave, sektori joformal tenton të hudh mbeturinat jashtë kontenjerëve dhe si e tillë vë vështirësi aktivitetet e mbledhjes për sektorin formal. Situata e keqe aktuale në lidhje me menaxhimin e mbeturinave është gjithashtu si rezultat i një pjese të pacaktuar të përgjegjësive të hisedarëve të këtij sektori, të cilët në shumicën e rasteve nuk i respektojnë dhe përmbushin detyrat e tyre. Kur është fjala për mënyrën e hudhjes së mbeturinave,

---

<sup>36</sup> KOSID. (2017). "Menaxhimi i mbeturinave përmes Ekonomisë Cirkulare, zgjidhja kundrejt degradimit mjedisor". Par. <http://kosid.org/sq/news/101>

<sup>37</sup> Infobox. (2017). "Menaxhimi i Mbeturinave është i ulët dhe larf direktivave të BE-së". <https://www.youtube.com/watch?v=JP7sFVzTMT8&feature=youtu.be&t=21m21s>

<sup>38</sup> Berisha, A. Komuna e Obiliqit. Intervistë. 31 Gusht 2017.



Kosova varet shumë nga deponitë josanitare. Përveç kësaj, duke pasur një mënyrë joefikase të deponimit, Kosova nuk zbaton parimin e 'Ndotësi paguan'. Sipas statistikave të Eurostatit, në vitin 2015 nga 319,034 ton, 99.98% u hodhën në deponi<sup>39</sup>. Pra, nëse merret parasysh kg/banor, kjo do të rezultojë në 177 kg/banor, ose 0.48 kg/banor/ditë. Edhe pse të dhënat në terren parashikohen të grumbullohen çdo vit dhe t'iu ofrohen Eurostat-it, palët përkatëse në Kosovë raportojnë në mënyrë sporadike dhe jo në baza vjetore. Prandaj, mungesa e të dhënave përbën një kërcënim të madh për politikëbërësit të cilët duhet të bëjnë vlerësime të sakta dhe për të ndërmarrin vendime adekuate, për shkak se ashpërsia e problemeve mjedisore mbetet ende e paqartë. Sa më shumë zhvillim ekonomik që kemi, aq më shumë mbeturina do të prodhojmë, prandaj një sistem i menaxhimit funksional të mbeturinave është vendimtar.

## Sfidat dhe Pengesat e Menaxhimit të Mbeturinave në Kosovë

Pasi të ketë identifikuar hisedarësit kryesor në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, ky punim trajton më tej sfidat dhe pengesat me të cilat ballafaqohen të gjithë këta hisedarës, në mënyrë që të mund t'i shohim qartë problemet ekzistuese që i pengojnë ata të ofrojnë shërbime kualitative dhe mjedis të pastër. Bazuar në hulumtimin primar dhe sekondar, pamundësia e hisedarëve për të ofruar efikasitet në sektor është si rezultat i problemeve si: mungesa e zbatimit të ligjit, mungesa e vullnetit politik, shprehitë jo adekuate të publikut, interesave vetanake të kompanive operative etj. Gjetja e zgjidhjeve të këtyre problemeve mund të ndihmojë shumë Kosovën në hartimin e politikave efektive që do të kontribuonin në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm në të ardhmen dhe si një mirëqenie afatgjate e të sigurt për qytetarët e saj.

Siç është pohuar më parë, aktivitetet e njeriut janë burimi kryesor i gjenerimit të mbeturinave. Shkalla e lartë e saj është një shqetësim global i cili përfshin edhe (veçanërisht) Kosovën, ku kjo sasi e madhe e mbeturinave pothuajse tërësisht përfundon në deponitë që janë në kushte mizore. Në Kosovë të gjitha llojet e mbeturinave (inerte, të rrezikshme, dhe jo të rrezikshme) hudhen në deponi, në të cilat deponi nuk bëhet klasifikimi i mbeturinave. Madje edhe institucionet të cilat hudhin mbeturinat e rrezikshme, të tilla si spitalet, përdorin kazanët e plehrave komunale dhe nuk i trajtojnë ato përpara se t'i hudhin ato. Sa i përket naftës, vetëm disa kompani marrin përsëri naftën e përdorur, të cilat pastaj mund të përdoren për nevojat e tyre gjatë dimrit, si ngrohje, ose ata e shesin në kompanitë e ndërtimit të rrugëve të cilat kanë nevojë për atë si material ndërtimor.

Duke marrë parasysh kapitalin e investuar, me vlerë prej 10 milionë EUR, nga BE-ja për ndërtimin e deponive rajonale të Kosovës, normalisht pritet që ato të jenë në gjendje më të mirë dhe gjithashtu

---

<sup>39</sup> Eurostat. (2017). "Municipal waste by waste operations".  
<http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

të kenë sistemet e nevojshëm për nxjerrjen e gazit dhe trajtimin e ujit. Për më tepër, në vitet e fundit ka pasur një rritje në mbledhjen e faturave, hyrjet monetare të cilat mund të përdoren për të investuar në përmirësimin e këtyre vendeve. Megjithatë, në kohën e ndërtimit katër nga deponitë e Kosovës nuk posedonin dhe nuk kishin të drejtë të merrnin një leje të integruar mjedisore nga qeveria, sepse ato nuk ishin ndërtuar në përputhje me standardet dhe fillimisht nuk ishin këshilluar nga MMPH-ja. Deponia e mbeturinave në Mirash, e cila është një nga më të mëdhatë në Kosovë, është në kushte shumë të këqija, duke mbajtur sasi të konsiderueshme të ujit dhe një numër të madh të mbeturinave, gjë që përbën një kërcënim të madh për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Për më tepër, ajo kërcënon qëndrueshmërinë e mjedisit dhe jetën e punëtorëve dhe banorëve të asaj zone. Në mungesë të sistemeve të tilla, rreziku i kontaminimit të ujërave nëntokësore rritet pasi shumica e qytetarëve të Kosovës e përdorin këtë lloj të ujit në baza ditore. Ndërsa sa i përket sistemit të nxjerrjes së gazit, rreziku nga zjarri dhe shpërthimeve për shkak të pranisë së metanit në deponi nuk është i pashmangshëm.

Sipas KMDK-së, shumica e pranuar e mbeturinave në katër deponitë, atë të Prishtinës, Prizrenit, Podujevës dhe Gjilanit, por edhe në stacionin e transferimit në Ferizaj, ishte 249,440 ton<sup>40</sup>.

---

*Deri në vitin 2019, niveli i gjenerimit të mbetjeve  
në Kosovë vlerësohet të rritet për 17.37%.*

---

Bazuar në këtë shumë, niveli i vlerësuar i mbeturinave të gjeneruara deri në vitin 2019 do të rezultojë në një rritje prej 43,328 ton, me normë vjetore prej 3%<sup>41</sup>. Prandaj, kostot operacionale të KMDK-së parashikohen të rriten gjatë këtyre viteve, p.sh. punësimin e stafit shtesë ku shpenzimet e përgjithshme të pagave dhe përfitimeve do të rriten, mirëmbajtja e pajisjeve dhe makinave të vjetra, shpenzimet e transportit si nafta dhe karburant etj. Kostot e tyre kanë tendencë të rriten ndjeshëm në vitet 2017 dhe 2018, pasi shumica e investimeve të parashikuara pritet të marrin vend gjatë viteve të ardhshme të cilat parashikohen të përfundojnë deri në vitin 2019; siç janë rehabilitimi i deponive, riinstalimi i sistemit të kullimit të ujërave të ndotura, furnizimi me makineri të reja dhe sistemin e nxjerrjes së gazit, ndërtimi i infrastrukturës së riciklimit në deponinë e Mirashit (Prishtinë) dhe stacionin e transferimit të mbeturinave në Ferizaj, monitorimi e deponive dhe hapja e sektorëve nëpër deponi, pasi shumica e tyre kanë arritur kapacitetet e tyre të plota. Pra, në thelb prioritetet e KMDK-së në planin e tyre për tre vitet e ardhshme janë të monitorojnë deponitë dhe të ofrojnë shërbime

---

<sup>40</sup> Kompania per Menaxhimin e Deponive ne Kosove. (2016). "Plani i Biznesit per vitin 2017-2019". Fq. 9.

[http://www.mzhe-ks.net/npmnp/repository/docs/2359\\_KMDK\\_Plani\\_i\\_Biznesit.pdf](http://www.mzhe-ks.net/npmnp/repository/docs/2359_KMDK_Plani_i_Biznesit.pdf)

<sup>41</sup> Fq. 8.

kualitative për klientët e tyre, të cilët mund të jenë kompanitë publike dhe private dhe nga investimet e tyre të reja të përshtaten me mënyrat e deponimit të mbeturinave komform ruajtjes së ambientit. Në Kosovë janë 15 kompani private që mbledhin dhe transportojnë mbeturina në komuna të përzgjedhura, si Prishtina, Klinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Prizren, Rahovec, Malishevë, Graçanicë etj. Megjithatë, kompanitë e lartpërmendura private për t'u licencuar nga komuna në të cilën ato ofrojnë shërbime. Roli i këtyre kompanive private është mbledhja, trajtimi, riciklimi dhe transportimi i mbeturinave deri në deponi. Ata mbledhin mbeturinat derë më derë dhe në pikat e grumbullimit

<b>Kompanitë Private</b>	<b>Komuna</b>
ASDA INSAAT	Prishtinë
Benita Company, SH.P.K	Gremnik
N.P.SH. Katana	Obiliq
N.SH.T. Kanalprofis	Fushë Kosovë
N.SH. Xhaferi	Prizren
SH.P.K Ekodrina	Rahovec
N.T.SH. ZAHIRI	Prishtinë
N.T.SH. Krasniqi	Kaçanik i Vjetër
N.N Lindi-2	Balincë-Malishevë
N.N.T Hamiti	Balincë-Malishevë
SH.P.K. Rec- Kos	Fushë Kosovë
SH.P.K. Toifor	Prishtinë
SH.P.K VIGANI	Prishtinë
SH.P.K. Plastika	Fushë Kosovë
P.P. Rata i Pet Brata	Graçanicë

Tab. 3. Lista e kompanive private

Për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre, kompanitë publike/rajonale kanë krijuar një shoqatë të quajtur PAMKos. Megjithatë, ka pasur raste kur kompanitë rajonale kishin përjetuar konflikte me komunat apo edhe KMDK-në. Si e tillë, shumë herë KMDK-ja i pengoi ndërmarrjet publike dhe kompanitë private që të depononin mbeturinat në deponi për shkak të borxhit të lartë që u detyrohen këtij institucioni. Megjithatë, meqë shërbimet e tyre konsiderohen si një e mirë publike, jo private, ato vazhdojnë të veprojnë në rrethana të tilla. Mesatarisht, 60% e familjeve paguajnë faturën e mbeturinave, ndërsa përqindja për bizneset është e barabartë me 70%, prandaj ndërmarrjet publike/rajonale nuk janë në gjendje të paguajnë detyrimet financiare në kohë. Përveç problemeve të inkasimit, ka edhe sfida të tjera me të cilat ballafaqohet ky sektor dhe i pengon ata të ofrojnë

shërbimet e tyre siç duhet, si prania e sektorit joformal i cili në kërkim për materiale të riciklueshme në pikat e grumbullimit shpërndajnë mbeturinat në atë zonë të caktuar jashtë kontenjerëve.

Sektori joformal, i cili është i përfshirë në mënyrë indirekte në kornizën institucionale të menaxhimit të mbeturinave, ka qenë i pranishëm në këtë sektor për një kohë të gjatë tani. Situata ekonomike dhe sociale e pafavorshme në Kosovë ka shtyrë ata që bien nën kufirin e varfërisë për të dalë në rrugë, për të kërkuar dhe mbledhur materiale të riciklueshme, kështu që në fund të ditës ata mund të kenë pak të ardhura duke i shitur ato tek kompanitë e vogla private me të cilët normalisht nuk janë në marrëdhënie kontraktuale. Për më tepër në fund të ditës, fitimi i një kompanije eksportuese të mbeturinave të riciklueshme me atë të grupeve ekonomiksht të ndikuara janë të pakrahasueshme. Ky komunitet përbëhet kryesisht nga grupet minoritare, siç janë romët, ashkalisht dhe egjiptianët, të cilët punojnë në kushte të tmerrshme pa veshje të përshtatshme dhe në rrethana tejet të rrezikshme. Aktivitete të tilla në disa raste kanë rezultuar me aksidente fatale. Për shembull, rasti i Elbasani Isufit i cili humbi jetën në deponinë e Gjilanit kur u shtyp nga kamioni i plehrave. Përveç tyre, duke kërkuar nëpër kazanët e mbeturinave të komunës, edhe pse të paautorizuar, këto grupe kërkojnë gjithashtu mbeturina të riciklueshme në deponi<sup>42</sup>. Prandaj, në disa deponi rrethimet janë të dëmtuara. Ka raste kur ata duhet të dalin dy herë në ditë në rrugë ose në vendet e caktuara për të mbledhur mbeturina të riciklueshme, në mënyrë që ata të mund të ushqejnë familjet e tyre. Më së shumti që ata mund të marrin është, mesatarisht, 5 deri në 6 Euro gjithmonë në varësi të çmimit të paguar nga kompanitë ricikluese. Mbeturinat e riciklueshme të mbledhura dërgohen direkt tek kompanitë ose në disa raste te pikat e grumbullimit të cilat ndodhen nëpër lagjet e tyre. Pas kësaj, mbeturinat e riciklueshme transportohen në kompani private të cilat pastaj eksportojnë jashtë Kosovës me kamionë. Vendet e synuara për eksport janë Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Turqia dhe Gjermania<sup>43</sup>. Është e dukshme edhe përfshirja e fëmijëve në këtë sektor, ku frekuentimi i këtyre fëmijëve nga komunitetet pakicë është mjaft i ulët. Kjo përfshirje e fëmijëve mund të konsiderohet si pasojë e menaxhimit joefektiv të mbeturinave. Kështu, duke marrë vendime të duhura dhe duke zbatuar politika të caktuara efektive, ky komunitet mund të kontribuojë në reduktimin e gjenerimit të mbeturinave dhe ta transformojë Kosovën në një shoqëri që riciklon.

Megjithatë, transformimi i shoqërisë sonë në atë që riciklon nuk është një detyrë e lehtë. Së pari, sepse mbetemi prapa në edukim efektiv dhe vetëdijesim në mesin e anëtarëve të komunitetit. Së dyti, ka pasur shumë projekte të riciklimit që kanë dështuar dhe kjo për arsye të thjeshtë të zbatimit joadekuat duke pasur parasysh kapacitetet e Kosovës, duke anashkaluar këshut boshllëqet strukturore. Prandaj

---

<sup>42</sup> Molliqaj, L. (2017). "Vdekja e paralajmëruar". *Preportr*. <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Vdekja-e-paralajmeruar-218>

<sup>43</sup> Boletini, B., and Molliqaj, L. (2015). "Sot punon sot han". *Preportr*. <http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Sot-punon-sot-han-75>

duhet bërë shumë punë për të lehtësuar pasojat e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë me mjete të caktuara të politikave që po zbatohen.

## Analiza krahasuese

Është argumentuar nga shumë hulumtues dhe agjenci se konsumi i burimeve në ekonominë e sotme është shumë i paqëndrueshëm. Gjatë dy dekadave të fundit, BE-ja ka promovuar fuqishëm qëndrueshmërinë mjedisore midis shteteve të saj anëtare; për shembull uljen e emetimeve të karbonit që vijnë nga automjetet dhe prodhimi i energjisë, riciklimin e mbeturinave komunale etj. Duke kaluar në teknologjitë prodhuese konform mbrojtjes së ambientit, njerëzit nuk përfitojnë vetëm në aspektin e mjedisit, por edhe atë ekonomik. Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit, në dekadën e fundit ka pasur një rritje prej 50% në GDP-të e vendeve të Evropës, ndërsa gazrat serë (GHGs) janë zvogëluar për 24%<sup>44</sup>. Një shenjë e mirë është se ka një nivel më të lartë të ndërgjegjësimit publik mbi ndikimet negative të menaxhimit të dobët të mbeturinave, megjithatë ende ekziston nevoja për ndërmarrje të veprimeve konkrete gjatë përdorimit të mjeteve dhe instrumenteve të ndryshme të politikave. Ky i fundit korrespondon në masë të madhe me vendet në zhvillim e sipër, siç është Evropa Juglindore, të cilat kanë shumë më tepër për të bërë sa i përket çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Kur është fjala për promovimin e riciklimit, duhet të ndryshojnë edhe sistemet e prodhimit dhe modelet e konsumit.

Hulumtimi ynë tregon se ka shumë shembuj të suksesshëm nga rajoni, përkatësisht rastet si ai i Kroacisë, Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Për shembull, Kroacia tregon një mundësi të mundshme se si të ndërtojme një menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave duke nxitur bashkëpunimin midis qeverive lokale. Kjo është bërë duke ndërtuar një sistem të grumbullimit dhe deponimit të përbashkët i cili vepron në bashkëpunim me kompanitë private dhe qeveritë lokale.

Sa i përket rastit të Maqedonisë, ata ndërtuan një deponi të përbashkët për mbeturinat e rrezikshme dhe infektive<sup>45</sup>. Duke pasur si prioritet rregullimin e çështjes së hudhjes së mbeturinave të rrezikshme, kjo praktikë po demonstroi rezultate të mira deri më tani. Vendet që përfituan më së shumti ishin vendet turistike, pasi këto deponi të përbashkëta u nisën në mënyrë specifike nga komunat të cilat përfitojnë më së shumti nga turizmi. Për më tepër, suksesi i këtij projekti ishte i mundur për shkak të sistemit logjistik të rregulluar i cili përfshin tre stacione transferimi dhe shtatë pika të vogla transferimi që u mundëson komunave të tjera që janë në distanca të gjata për të menaxhuar mbeturinat e tyre.

---

<sup>44</sup> European Environmental Agency. (2017). "Circular economy in Europe: we all have a role to play". Par. 2. <https://www.eea.europa.eu/articles/circular-economy-in-europe-we-all-have-a-role-to-play>

<sup>45</sup> Institute for Development Research Riinvest. (2016). "Waste Management In 16 Municipalities: Opportunities For Inter-Municipal Cooperation". Fq.28. [http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/20/Waste\\_Management\\_in\\_16\\_Municipalities\\_ENG1474375664.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/20/Waste_Management_in_16_Municipalities_ENG1474375664.pdf)

Pesë qytete kryesore janë përgjegjëse për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave. Ky projekt në veçanti nxiti edhe riciklimin.

Rasti i Serbisë mbetet pak i njëjtë me atë të deponisë rajonale në Maqedoni, megjithatë ai përfshin më shumë stacione transferimi dhe pika të grumbullimit<sup>46</sup>. Projekti i saj u financua nga BE-ja dhe bazuar në raportet të ndryshme që u bënë në lidhje me këtë deponi, për shkak të madhësisë së deponisë prej 46 hektarësh të dedikuar për deponimin përfundimtar të mbeturinave, rezultoi të jetë projekt i suksesshëm në zbutjen e impakteve negative të menaxhimit të mbeturinave. Ngjashëm edhe Mali i Zi ndërtoi një deponi rajonale, përderisa në të njëjtën kohë krijoi qendra riciklimi.

Nëse projektet e përmendura më parë janë ndërmarrë kryesisht nga qeveritë lokale, në Shqipëri projekti i menaxhimit të mbeturinave u ndërmorr nën drejtimin e Shoqatës së Zadrimes, e cila shoqatë është një përfaqësim i komunikimit ndërkomunal. U regjistrua si një organizatë joqeveritare dhe përfshin pesë qeveri lokale nga pjesa veriore e Shqipërisë. Shoqata kishte të drejtë të merrte çdo lloj mase drejt lehtësimit të pasojave të menaxhimit të mbeturinave<sup>47</sup>. Dhe, siç shihet nga shembujt e rajonit, bashkëpunimi ndërkomunal është një prej praktikave më të zbatuara, prandaj realizimi i një projekti që promovon një bashkëpunim të tillë do të mund të çonte në rezultate të mira.

Në anën tjetër, duke konsideruar vendet e tjera evropiane që duket se janë duke performuar shumë më mirë në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, dhe veçanërisht riciklimit, mund të shohim politika të ndryshme dhe efektive që autoriteteve që merren me këtë sektor. Për shembull, Portugalia ka përfshirë Trajtimin Biologjik Mekanik (MBT) i cili është një sistem që përpunon mbeturinat me anë të kompostimit ose tretjes anaerobe, i cili pastaj mund të përdoret për bujqësi apo edhe për energji elektrike dhe ngrohje<sup>48</sup>. Për më tepër, ajo ka përafuar plotësisht legjislacionin kombëtar me atë të Direktivave të BE-së dhe ka prezantuar taksën e deponive në vitin 2007 i cili në vlerë duket se është rritur me kalimin e kohës. Sa i përket hisedarëve që i kanë vendosur objektiva të caktuara sektorit të menaxhimit të mbeturinave, e posaqërisht nivelit të gjenerimit dhe riciklimit të mbeturinave, do të vendoset një taksë e re për ata që nuk e arrijnë këtë qëllim; një taksë që nuk do tëu ngarkohet konsumatorëve por prodhuesve. Portugalia gjithashtu zbaton parimin “Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesve” në lidhje me paketimin e produkteve.

Ashtu si Portugalia, Sllovenia, një shtet tjetër anëtar i BE-së, ka implementuar policinë e taksës së deponimit të mbeturinave të mbledhura tek operatorët e deponive, nga i cili të ardhurat e fituara l

---

<sup>46</sup> Fq. 28.

<sup>47</sup> Institute for Development Research Riinvest. (2016). “Waste Management In 16 Municipalities: Opportunities For Inter-Municipal Cooperation”. Fq. 29.  
[http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/20/Waste\\_Management\\_in\\_16\\_Municipalities\\_ENG1474375664.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/20/Waste_Management_in_16_Municipalities_ENG1474375664.pdf)

<sup>48</sup> European Environment Agency. (2016). “Portugal – Municipal Waste Management”.  
<https://www.eea.europa.eu/publications/managing-municipal-solid-waste/portugal-municipal-waste-management/view>

atribuohen sektorit të riciklimit. Sllovenia miratoi disa programe kombëtare mjedisore të cilat promovuan shumë hierarkinë e menaxhimit të mbeturinave në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave të gjeneruara. Përveç kësaj, Sllovenia ka përvetësuar skemën e “pay-as-you-throw” (shqip: paguaj-kur-gjuan); skemë kjo që ngarkon prodhuesin me një vlerë të caktuar monetare bazuar në sasinë se sa gjeneronë mbeturina<sup>49</sup>.

Përveç futjes së taksës së deponisë, disa vende evropiane shkuan aq larg sa ndaluan hudhjen e mbeturinave të djegshme dhe disa të caktuara komunale në deponi, p.sh. Suedia dhe Zvicra. Ndërsa vendet si Belgjika aplikojnë dënime të rënda me vlerë deri në 625 euro nëse ekonomitë familjare nuk i ndajnë mbeturinat në burim<sup>50</sup>. Në përgjithësi, është thelbësore për autoritetet qeverisëse dhe hisedarësit e sektorit për menaxhimin e mbeturinave të bashkëpunojnë mes njëri-tjetrit në mënyrë që të ofrojnë shërbime të përshtatshme dhe kualitative për konsumatorët.

## Përfundimet

Për të përmbledhur, sfidat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave vijnë si pasojë e zbatimit të pjesshëm dhe joefektiv të ligjit për mbeturinat dhe udhëzimeve administrative që i ngarkojnë hisedarësit me përgjegjësi shtesë, pasi ata janë përfaqësuesit e institucioneve kompetente për hartimin e politika të këtij sektori në mënyrë që të zbusin ndikimet negative të imponuara në mjedis dhe shëndetin publik. Kosova ka gjetur veten në këtë pozitë që është sot për shumë arsye si: rritja e shpejtë e popullsisë dhe industrializimi, përgjegjësitë e padefinuara midis hisedarëve që rezultojnë në zbatimin e pjesshëm të ligjit, mungesën e inspektoratit dhe teknologjive të avancuara për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, varësi të lartë nga donatorët për mbështetje financiare dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme shprehite e qytetarëve lidhur me nivelin e gjenerimit dhe hudhjen e mbeturinave.

Nëse nuk ndërmerret ndonjë veprim i menjëhershëm, ndikimet negative në mjedis dhe në shëndetin publik do të intensifikohen edhe më shumë për gjeneratat e tanishme dhe ato të ardhshme. Përveç degradimit të mjedisit, shkatërrimit të estetikës, aromave të këqija, shpërthimeve të mundshme dhe dëmtimit të pronës, shëndeti publik është vënë në rrezik me shumë sëmundje që përhapen në mesin e komunitetit që jeton me burimet e ndotura të jetës, si uji, ajri dhe toka. Sëmundjet më të zakonshme përfshijnë sistemin nervor, lëkurën, sistemin e frymëmarrjes, zemrën dhe veshkën.

---

<sup>49</sup> European Environment Agency. (2016). “Slovenia – Municipal Waste Management”.  
<https://www.eea.europa.eu/publications/managing-municipal-solid-waste/portugal-municipal-waste-management/view>

<sup>50</sup> European Environment Agency. (2016). “Belgium – Municipal Waste Management”.  
<https://www.eea.europa.eu/publications/managing-municipal-solid-waste/portugal-municipal-waste-management/view>

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave, tendencat e BE-së lëvizin drejt aplikimit të instrumenteve ekonomike, p.sh. ngarkimi me taksa apo tarifa për ciklin e mbeturinave, subvencionimin e firmave potenciale të riciklimit, dizajnimin e skemave tregtare për emetimet e mbeturinave që vijnë nga prodhimi i mbeturinave etj. Në parim, prioritetet e vendosura nga politikat e BE-së në lidhje me menaxhimin e mbeturinave janë zvogëlimi i nivelit të përgjithshëm të mbeturinave të gjeneruara brenda shteteve anëtare, inkurajimi i ripërdorimit të mbeturinave dhe eksportimin/importimin e tyre në bazë të rregullave strikte, deponimi adekuat etj., kështu që kur mbeturinat të hudhen në mjedis të mos jenë të dëmshme. Si për mbeturinat e rrezikshme, së pari duhet të ndodhë identifikimi i llojit të mbeturinave nga zotëruesi apo prodhuesi i mbeturinave, taktikat dhe synimet për parandalimin e gjenerimit të këtyre mbeturinave, pastaj të zbatohen stimujt ekonomik dhe së fundi të përcaktohen përgjegjësitë e zotëruesit/prodhuesit të mbeturinave dhe të ndikojnë në ndryshimin e modeleve të konsumit tek konsumatorët ndaj mallrave që gjenerojnë sasi të vogla të mbeturinave.

Me qëllim të lehtësimit të pasojave të praktikave jo të mira të menaxhimit të mbeturinave, qeveria e Kosovës në kornizën ligjore ka renditur prioritetet lidhur me këtë sektor, të cilat përbëhen nga ngritja e vetëdijes mbi mbrojtjen e mjedisit, parandalimi i shkallës së lartë të prodhimit të mbeturinave, rivendosja e deponive dhe investimi në deponitë konform normave mjedisore, rritja e kapaciteteve për biomasë, investimi në rrjet dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbeturinave, monitorimi i rreptë i hisedarëve dhe së fundi ngritjen e tarifave të mbledhura mbi ekonomitë familjare dhe bizneset. Kur bëhet fjalë për tarifën e vendosura për marrësit e shërbimit të mbeturinave, duke filluar nga viti 2018, faturat e mbeturinave do të mbledhen së bashku me pagesën e tatimit në pronë. Kjo mendohet të ndihmojë komunën në ofrimin e shërbimeve efektive të menaxhimit të mbeturinave dhe mjedisit më të pastër, pasi gjatë gjithë vitit, një nga sfidat më të mëdha të kompanive të grumbullimit të mbeturinave mbetet grumbullimi i faturave nga marrësit e shërbimeve të tilla. Sfidat tjera të sektorit përfshijnë mungesën e inspektoratit, deponive me kapacitet të ulët që do të mbyllen për 2-3 vitet e ardhshme, sektorin informal dhe punën e fëmijëve etj.

Sektori i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë financohet kryesisht nga donatorët ndërkombëtar, të cilët gjithashtu shprehin interesimin e tyre për krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm që merr formë të ndryshme. Kohët e fundit, hisedarësi kryesor në bashkëpunim me GIZ organizoi një konkurs i cili mbledhi 17 komuna, ku një nga rezultatet më të mira ishte që komunat hartuan planin e tyre për menaxhimin e mbeturinave brenda komunitetit. Për më tepër, mbledhja e faturave është ngritur dhe përmirësime të vogla janë vërejtur në komunat pjesëmarrëse. Megjithatë korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave është përafër me Direktivat e BE-së, ende ekziston nevoja për të hartuar udhëzime të reja administrative, për shembull " Parimi i përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit" ende nuk është i aplikueshëm në Kosovë.



Pasi Kosova riciklon vetëm 5% të mbetjeve të riciklueshme, deri në vitin 2020, është e pamundur që ajo të arrijë 50%; një objektiv i vendosur nga BE për reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe inkurajimin e riciklimit. Prandaj, Kosova mund të marrë qasje të ndryshme në përmirsimin e situatës së menaxhimit të mbeturinave, ose duke ndarë siç duhet përgjegjësitë ose duke implementuar politika me anë të së cilave mund të promovojë zhvillim të qëndrueshëm mjedisor.

## Rekomandimet

Për t'i parë tendencat pozitive dhe përmirësimet në lidhje me sfidat mjedisore në Kosovë, posaçërisht ato të menaxhimit të mbeturinave, hartimi dhe zbatimi i masave dhe teknikave të ndryshme do t'u mundësonte komunave që të reduktonin intenzitetin e efekteve negative të këtij sektori. Për fat të mirë, Kosova ka një legjislacion, strategji dhe plan për menaxhimin e mbeturinave dhe kornizën institucionale të definuar, por pas disa viteve që nga përpilimi i saj ajo ende lufton me implementimin e kornisë ligjore. Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e përmendur në këtë hulumtim, Kosova mund të ndërmarrë disa zgjidhje të përballueshme dhe reale në drejtim të menaxhimit të mbeturinave, të cilat janë renditur më poshtë:

1. *Krijimi i një inspektorati funksional*, njësi që do t'i shtonte vlerë përpjekjeve për vendosjen e qëndrueshmërisë mjedisore në Kosovë, në veçanti menaxhimit të mbeturinave, duke identifikuar dhe eliminuar deponitë ilegale, duke aplikuar ndëshkime për qytetarët dhe kompanitë që shkelin ligjet. Veprimet e kryera nga inspektorët janë thelbësore për rregullimin e sektorit. Megjithatë, të dyja inspektoratet në Kosovë, atë të MMPH dhe komunës, nuk janë të pajisura mirë me burime njerëzore dhe financiare. Në këtë drejtim, MMPH-ja mund të përshpejtojë zbatimin e 'Policisë së Gjelbër', projekt i cili mendohet të zbatojë ligjet në fuqi dhe të promovojë planifikimin adekuat hapësinor. Për më tepër, do të ndërhynte në kohën e katastrofave natyrore, si dhe në rastet e emergjencave që do të ishin të prirura për të shkatërruar mjedisin mjedisor.

2. *Ndërtimi i deponive të reja* përbënte një nga rekomandimet që dalin nga KMDK-ja, gjë që do të kontribuonte në qëndrueshmërinë mjedisore. Kapaciteti i katër deponive ekzistuese për të pranuar mbeturina në afat kohor është vetëm edhe 3 vjet. Prandaj, hapja e deponive të reja do të ishte e favorshme, megjithatë ato duhet të jenë në përputhje me standardet e ndërtimit të BE-së. Në kundërshtim me katër lokacionet aktuale të deponimit, ato të reja duhet të kenë sisteme adekuate dhe të pajisura me leje mjedisore. Kjo do të thotë që lokacioni duhet të planifikohet më përpara nga planifikuesit urban në mënyrë që asnjë komunitet të mos ndikohet nga efektet anësore të deponimit. Në çdo moment, kjo nuk duhet të nënkuptojë mbështetje të madhe në deponitë, por duhet të ketë edhe praktika të riciklimit.

3. *Inkurajimi i krijimit të një sistemi të besueshëm informativ*, i cili do të thotë raportim periodik të të dhënave dhe monitorim i hisedarëve të menaxhimit të mbeturinave; një komponent i këtij sektori që ende mbetet i dobët në cilësi dhe sasi. Raportimi i të dhënave në Kosovë ka ndodhur mjaft sporadikisht. Kjo i pengon politikëbërësit që të bëjnë parashikime të sakta për qëllime të planifikimit dhe të ndërmarrjes së veprimeve adekuate. Për më tepër, kjo nuk mund të masë performancën e hisedarëve. Një sistem i mirë informacioni do të përfshinte MMPH-në dhe komunat të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë do t'i siguronin njëri-tjetrit të dhëna lidhur me situatën aktuale të mbeturinave në komunitet dhe kështu të ndërmerrnin veprime të menjëhershme kurdoherë që do të ishte e nevojshme.

4. *Rritja e kapaciteteve në nivel qendror dhe lokal*, duke qenë ato burime njerëzore ose financiare. Përveç burimeve njerëzore dhe financiare, kapacitetet administrative në nivel qendror dhe lokal janë të ulëta. Prandaj, duke marrë në konsideratë diskutimet me hisedarësit, ka nevojë që komunat të kenë njësi speciale që merren veçanërisht me mbeturinat komunale. Vetëm një komunë deri më tani ka këtë njësi që është funksionale. Për më tepër, pjesa e përgjegjësive dhe detyrave duhet të përcaktohet qartë, kështu që të mos ketë ndërhyrje në kompetencat e njëri-tjetrit.

5. *Subvencionimi i kompanive të riciklimit dhe atyre të mbeturinave të veçanta*, si nafta, automjetet, gomat etj. Do të nxitnin ekonominë qarkore brenda komunitetit. Ndërkohë, dhënia e stimujve për qytetarët për klasifikimin e mbeturinave në burim, të cilat mbeturina do të pranoheshin nga kompanitë e subvencionuara do të shtonin vlerë në ciklin e mbeturinave. Për shembull, sistemi i rimbursimit (ang. deposit-refund) do të ishte i përshtatshëm. Sa i përket mbeturinave të veçanta, të cilat fragmenti i menaxhimit të mbeturinave ka stagnuar shumë, subvencionet mund të ofrohen për kompanitë e çertifikuara që do të grumbullonin dhe trajtojnë siç duhet mbeturinat e tilla që ndonjëherë mund të jenë mjaft të rrezikshme dhe të imponojnë kërcënime të mëdha në komunitet. Megjithatë, ekzistojnë rreziqe dhe pengesa lidhur me zbatimin e këtyre zgjidhjeve të politikave. Ende mund të ketë mungesë të vullnetit politik për zbatimin e rekomandimeve. Qeveria lokale mund të vazhdojë të operojë nën planifikimin strategjik të pacaktuar për përmirsimin e menaxhimit të mbeturinave, duke mos përmbushur interesin e publikut. Rreziku i angazhimit të kompanive private që kanë interes personale në vend të atyre publike, dhe nuk sjellin asnjë përfitim për qëndrueshmërinë mjedisore, pasi që duket se përfitimet financiare mbeten forca kryesore që i drejton këto kompani.

## Appendix

### Korniza Ligjore dhe Strategjike e Menaxhimit të Mbeturinave

- Ligji për mbeturina (Ligji Nr. 04/L-060),
- Direktivat e BE-së për Mbeturina dhe Kimikate,
- Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022,
- Plani për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2017,
- Planet Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave,
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.08/2017 Për Menaxhimin E Deponive Të Mbeturinave,
- Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 06/2016 Mbi Kushtet për Zgjedhjen e Lokacionit dhe Ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave,
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr.01/2015 për Listën e OECD-së për Mbeturina,
- Udhëzim Administrativ MMPH -Nr. 05/2015 për Menaxhimin e Bifenileve dhe Trefenileve të Polikloruara dhe Mbeturinave me PCB dhe PCT,
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 07/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave Nga Ndërtimi dhe Demolimi i Objekteve Ndërtimore,
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 10/2015 për Trajtimin e Mbeturinave Nga Produktet Medicinale,
- Udhëzimi Administrativ MMPH - Nr. 14/2015 për Ndëshkimet me Gjoha Mandatore,
- Udhëzim administrativ MMPH - Nr. 15/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Gypat Fluoreshent që Përmbajnë Merkur,
- Udhëzim administrativ MMPH - Nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë Azbest,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2014 për Kompetencat e Zotëruesit të Mbeturinave, Prodhuesit dhe Importuesit të Produktit,
- Udhëzimi Administrativ Nr.09/2014 Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave,
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 20/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave Biodegraduese,
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 21/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave Nga Industria Ekstraktive dhe Minerave,
- Udhëzim Administrativ MMPH – Nr. 25/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave Nga Paisjet Elektrike dhe Elektronike dhe Kufizimin e Përdorimit të Substancave të Rrezikshme në Paisjet Elektrike dhe Elektronike,
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr.26/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Bateritë dhe Akumulatorët,
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 27/2014 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ambalazhet dhe Paketimet,
- Udhëzim Administrativ Nr. 05/2013 për Menaxhimin e Vajrave të Përdorura dhe Mbeturinave me Vajra,
- Udhëzim Administrativ Nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave,
- Udhëzim Administrativ Nr. 16/2013 për Vlerat Kufitare të Përqendrimeve për Komponentet e Rrezikshme në Mbeturina,
- Udhëzim Administrativ (MMPH) Nr. 22/2013 për Menaxhimin e Mbeturinave Medicinale Humane dhe Veterinare,
- Udhëzim Administrativ Nr. 23/2012 për Menaxhimin e Gomave Jashtë Përdorimit dhe Mbeturinave të Gomës,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 19/2012 për Menaxhimin e Automjeteve Mbeturinë dhe Komponentët e tyre,

- Udhëzimi Administrativ Nr.20/2012 për Eksport, Import dhe Transit të Mbeturinave,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2008 për Administrimin me Mbeturinat Medicinale,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2008 për Administrimin e Mbeturinave të Rrezikshme,
- Udhëzimi Administrativ Nr.12/2008 për Asgjësimin e Mbeturinave të Produkteve Medicinale,
- Udhëzimi Administrativ - Nr. 36/07 për Ambalazhin dhe Ambalazhet Mbeturinë,
- Udhëzimi Administrativ Nr. 39/07 për Administrimin e Mbeturinave nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike,
- Udhëzimi Administrativ - Nr. 80/07 për Mbeturinat nga Bateritë dhe Akumulatorët e Shpenzuar,
- Rregullore Nr. 02/2012 për Administrimin e Mbeturinave Minerare.<sup>i</sup>

---

<sup>i</sup> Marrë nga Zyra e Kryeministrit. Web. [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REGJISTRI\\_I\\_AKTEVE\\_NENLIGJORE.\\_P%C3%ABrditesuar\\_m%C3%AB\\_\\_20..10.2017.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/REGJISTRI_I_AKTEVE_NENLIGJORE._P%C3%ABrditesuar_m%C3%AB__20..10.2017.pdf)